


RAPORT VJETOR PËR KRIMET NGA URREJTJA

NË VITIN
2020

KRIMET NGA
URREJTJA



Përkrahur nga

osbe Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup

Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup.

Botues:

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut,
përfaqësuar nga Kryetari prof. dr. Gordan Kallajxhiev

Redaktor:

Uraniija Pirovska

Автори:

Mr. Vildan Drpljanin

Përkthim:

Armina Sinani

Lekturë:

Shenasi Jaji

Dizajni:

Polyesterday – Digital Imaging

Shtypi:

Polyesterday

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

343.3/.7:316.647.5(497.7)“2020”(047)

DRPLJANIN, Vildan

Raporti vjetor për krimet e urrejtjes në 2020 [Електронски извор] /
[Vildan Drpljanin]. - Shkup : Komiteti i Helsinkit për të drejtat e
njeriut, 2021

Начин на пристапување (URL): <http://www.mhc.org.mk/>. - Текст во PDF
формат, содржи [101] стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис
на изворот на ден 03.03.2021. - Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4790-85-3

a) Злосторства од омраза -- Македонија -- 2020 -- Извештаи
COBISS.MK-ID 53304325



**KOMITETI I
HELSINKIT PËR
TË DREJTAT E
NJERIUT**

Naum Naumovski Borçe 83
1000, Shkup
Tel: +389 (0)2 3119 073
Faks: +389 (0)2 3290 469
Web: www.mhc.org.mk
E-mail: helkom@mhc.org.mk

PËRMBAJTJA

1. PËR PROJEKTIN	4
2. METODOLOGJIA	6
2.1 Të mësuarit nga përvojat dhe të dhënat në të kaluarën.....	6
2.2 Mirëmbajtja e një faqe interaktive interneti për raportimin e krimeve të urrejtjes	7
2.3 Monitorimi i mediave kombëtare të shkruara dhe elektronike	7
2.4 Raportimi dhe kontrolli i dyfishtë i krimeve dhe incidenteve të urrejtjes	8
3. REZYME E GJETJEVE KRYESORE.....	9
3.1 Konteksti	9
3.2 Numri i incidenteve.....	11
3.3 Lloji i veprave penale	14
3.4 Incidentet sipas vendndodhjes	14
3.5 Incidentet sipas muajve.....	16
3.6 Incidentet sipas motiveve të njëanshme	16
3.7 Viktimat dhe autorët e krimeve.....	17
3.8 Statusi i rasteve	17
4. AKTIVITETET E EKIPIT PROJEKTUES.....	19
4.1 Monitorimi i incidenteve/krimeve të urrejtjes.....	19
4.2 Rishikimi i rasteve të raportuara të urrejtjes dhe kontributi për Raportin vjetor të ODIHR-së	19
4.3 Formimi i një rrjeti joformal për monitorimin dhe regjistrimin e krimeve të urrejtjes.....	20
4.4 Formimi i një rrjeti joformal për monitorimin dhe regjistrimin e krimeve të urrejtjes	20
4.5 Pjesëmarrja në dy punëtori për rritjen e ndërgjegjësimit dhe ndërtimit të kapaciteteve	20
4.6 Përgatitja e buletineve mujore për situatën me krimet e urrejtjes në vend	21
4.7 Përgatitja, përkthimi dhe publikimi i raportit të monitorimit për vitin 2020	21
4.8 Shënimi i Ditës evropiane të viktimave të krimeve nga urrejtja.....	22
4.9 Ofrimi i ndihmës juridike viktimave të incidenteve të urrejtjes dhe monitorimi i proceseve gjyqësore.....	22
4.10 Infografik me pasqyrë të dhënash për 8 vitet e kaluara	25
4.11 Aksion i përbashkët me Qytetin e Shkupit për heqjen e mbishkrimeve që përmbajnë gjuhë të urrejtjes	27
5. PËRFUNDIME	31
6. REKOMANDIME	33
ANEKSI – INCIDENTET E REGJISTRUARA NGA URREJTJA PËR VITIN 2020	34

1. PËR PROJEKTIN

Ky është raporti vjetor i 8-të me rradhë i botuar nga Komiteti i Helsinkit, megjithëse për here të parë në rrethana kaq të pazakonta. Pandemia me KOVID-19 shkaktoi efekte globale në përmasa të pakrahasueshme. Kriza shëndetësore me rritje të shpejtë, e cila ka goditur pothuajse çdo vend në botë, po shkakton pasoja të paparashikueshme ekonomike dhe sociale, nga të cilat njerëzimi gjatë kohë nuk do të rimëkëmbet. Duke marrë parasysh seriozitetin dhe paparashikueshmërinë e ngjarjeve, shumë qeveri, përfshirë edhe atë të Maqedonisë së Veriut, e konsideruan të domosdoshme shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, në mënyrë që të adresonin siç duhet rreziqet dhe dëmet e koronavirusit të ri. Meqenëse në kohë të gjendjes së jashtëzakonshme Qeveria mund të ndërmarrë veprime përtej asaj që normalisht do të lejohej, kjo gjithashtu nënkuptonte një alarm për vigjilencë nga aktivistët për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.¹ Sidoqoftë, 'tradita' negative e raportimit të krimeve nga urrejtja me numër 3-shifror, nga të cilat dominonin ato mbi baza etnike dhe politike, vazhdoi edhe këtë vit në Maqedoninë e Veriut.

Këto gjetje janë rezultat i projektit 'Mbështetje Maqedonisë së Veriut në fuqizimin e sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut' i cili u mbështet financiarisht nga Misioni i OSBE-së në Shkup dhe u zbatua nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2020. Projekti kishte për qëllim të përmirësonte zgjidhjet ligjore dhe institucionale në fushën e të drejtave të njeriut dhe atë kundër diskriminimit përmes ndryshimeve të legjisllacionit dhe politikave, përdorimit të mjeteve juridike efektive dhe duke forcuar institucionet. Një nga qëllimet ishte dhe mbetet përmirësimi i përgjigjeve të shtetit ndaj krimeve nga urrejtja dhe gjuhës së urrejtjes përmes monitorimit, regjistrimit dhe përpunimit të këtyre veprave në përputhje me kornizën e ndryshuar legjisllative. Këto aktivitete pritej të rrisnin vetëdijen për efektet e dëmshme të gjuhës së urrejtjes dhe intolerancës. Shpresojmë që këto rezultate do të shërbejnë si një thirrje për veprim për parandalimin e mëtejshëm të krimeve nga urrejtja dhe gjuhës së urrejtjes.

Hapi i parë për të siguruar një sistem efikas në funksion të mbrojtjes së viktimave të krimeve nga urrejtja është ndërtimi i kapaciteteve të institucioneve të drejtësisë penale në pjesën e regjistrimit të incidenteve të urrejtjes. Më konkretisht, ky raport është dizajnuar të shërbejë si një indikator i fushëveprimit, natyrës dhe shpeshtësisë së incidenteve nga urrejtja të kryera në vendin tonë.

¹ Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, *Raport i veçantë mbi situatën e të drejtave të njeriut në Maqedoninë e Veriut gjatë pandemisë me KOVID-19*, i botuar më 13 tetor 2020.

Brenda mandatit të tij si një partner implementues, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut gjatë vitit 2020 ka realizuar këto aktivitete, të cilat do të vazhdojnë të realizohen edhe gjatë gjithë vitit 2021, në lidhje me krimet nga urrejtja:

- 2.1.** Monitorimin dhe regjistrimin e krimeve dhe incidenteve nga urrejtja, me theks të veçantë të dhunës politike, sportive, të miturve dhe dhunës me motive të njëanshme midis të rinjve;
- 2.2.** Rishikimin e rasteve të raportuara të urrejtjes dhe kontributi për Raportin vjetor të ODIHR-së mbi krimet dhe incidentet e urrejtjes në Rajonin e OSBE-së për vitin 2020;
- 2.3.** Mirëmbajtjen, përditësimin dhe promovimin e faqes së internetit www.zlostorstvaodomraza.com në maqedonisht, shqip dhe anglisht, si dhe faqet në Facebook dhe Twitter;
- 2.4.** Themelimin e një rrjeti joformal të veprimtarëve/aktivistëve për të monitoruar dhe regjistruar krimet të urrejtjes kundër grupeve specifike të synuara, të tilla si komuniteti LGBT, romët dhe personat me aftësi të kufizuara;
- 2.5.** Pjesëmarrjen në dy punëtori për ngritjen e vetëdijes dhe ndërtimin e kapaciteteve, të organizuara nga Misioni për parandalimin e krimeve të urrejtjes që përfshijnë të rinjtë, duke prezantuar punën e Komitetit të Helsinkit referuar krimeve nga urrejtja;
- 2.6.** Përgatitjen e buletineve mujore informative mbi situatën e krimeve nga urrejtja;
- 2.7.** Përgatitjen, përkthimin dhe botimin e raportit të monitorimit për vitin 2020 në maqedonisht, shqip dhe anglisht;
- 2.8.** Shënimin e Ditës së propozuar të viktimave të krimeve nga urrejtja (22 korrik) duke organizuar një konferencë shtypi dhe eventin 'Turlitava';
- 2.9.** Ofrimin e ndihmës juridike viktimave të incidenteve nga urrejtja dhe monitorimin e proceseve gjyqësore të rasteve të zgjedhura të krimeve nga urrejtja që kanë të bëjnë me karakteristika të ndryshme mbrojtëse;
- 2.10.** Përgatitjen, botimin, promovimin dhe distribuimin e infografikut me të dhëna përmbledhëse mbi krimet nga urrejtja për 8 vitet e kaluara;
- 2.11.** Organizimin e një aksioni të përbashkët me Qytetin e Shkupit për heqjen/largimin e mbishkrimeve/grafiteve që përmbajnë gjuhë të urrejtjes.

Të gjitha informatat dhe të dhënat e mbledhura në lidhje me projektin gjatë 8 viteve të kaluara janë publikisht në dispozicion në faqen e internetit të Komitetit të Helsinkit.²

² Raporti i Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, në dispozicion në <https://mhc.org.mk/izveshtai/>.

2. METODOLOGJIA

Si në shkallë botërore, ashtu edhe në Maqedoninë e Veriut, shumica e krimeve nga urrejtja nuk denoncohen.³ Arsyeja kryesore prapa kësaj është supozimi se viktimat nuk besojnë se autoritetet do të ndër marrin veprime ose i frikësohen shpenzimeve dhe procedurave të gjata.⁴ Për shkak të kësaj, çdo informatë që mund të merret në drejtim të parandalimit është shumë e rëndësishme për të kuptuar llojet më të zakonshme të incidenteve, tendencat negative, vendngjarjet dhe raportin midis viktimave dhe autorëve të veprave. Si pasojë, është e rëndësishme të përmendet se krimet nga urrejtja nuk janë një fenomen që prekin vetëm pakicat, por më tepër janë një sulm direkt ndaj shoqërive demokratike dhe parimeve mbi të cilat bazohen të drejtat e njeriut.

Incidentet e urrejtjes nuk ndodhin rastësisht, ato janë manifestim i dhunshëm i përçarjeve, stereotipeve dhe paragjyqimeve, fenomene që depërtojnë thellë dhe helmojnë shoqëritë tona. Duke pasur si cak identitetin e një personi, krimet nga urrejtja shkaktojnë dëme dhe pasoja më të mëdha sesa veprat e thjeshta penale. Viktimat e drejtpërdrejta të krimeve nga urrejtja, si dhe personat e afërm që i përkasin të njëjtit grup, mund të përjetojnë trauma të mëdha dhe rritje të ndjenjës së pasigurisë për faktin se ata janë zgjedhur për shkak të disa karakteristikave të tyre që nuk mund t'i ndryshojnë. Zgjidhja më e mire për trajtimin e krimeve nga urrejtja, kur ato tashmë kanë ndodhur, është ndjekja dhe sanksionimi adekuat. Ky veprim publik i jep siguri viktimës se përvoja e tyre është identifikuar saktë dhe plotësisht, i cili më tutje ndjell vetëbesimin te pjesëtarët e tjerë të komunitetit se krimet nga urrejtja nuk do të kalojnë të pandëshkuara.⁵ Në këtë kuptim, ligjet pa zbatimin praktik të dispozitave të tyre nuk kanë vlerë më të madhe se letra mbi të cilën janë shkruar.

Për këto arsye, është shumë e rëndësishme të kuptohen qartë termat dhe metodologjia e përdorur nga autorët në përpilimin e këtij raporti. Prandaj, është e rëndësishme të qartësohet se 'krimet nga urrejtja' nënkuptojnë krime të motivuara nga intoleranca, d.m.th. paragjyqimet ndaj ndonjë grupi të caktuar në shoqëri. Kështu, çdokush mund të jetë viktimë e një vepre penale të urrejtjes, megjithëse pjesëtarët e komuniteteve të cënueshme janë viktimat më të zakonshme. Krimet nga urrejtja shpesh janë të drejtuara ndaj pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme etnike, religjioze dhe ndërtesave të shenjta fetare, romëve, pakicave seksuale dhe personave të zhvendosur brenda vendit.

Prandaj, metodologjia për raportimin e krimeve nga urrejtja në kuadër të këtij raporti përbëhet prej mësimave të nxjerra nga përvojat dhe të dhënat e mëparshme, mirëmbajtjes së një faqe interaktive të internetit për raportimin e krimeve nga urrejtja, monitorimin e shtypit dhe mediave elektronike kombëtare dhe raportimin dhe kontrollin e dyfishtë të incidenteve dhe krimeve nga urrejtja së bashku me Misionin e OSBE-së në Shkup.

3 Jacobs, J.B., & Potter, K. (1998). *Hate crimes: Criminal law & identity politics*. Oxford University Press.

4 Lippman, M. (2009). *Contemporary criminal law: concepts, cases, and controversies*. Sage.

5 Më detajisht e shtjelluar në GJEDNJ në GJEDNJ, *Sheçiç kundër Kroacisë*, Aplikacioni Nr. 40116/02, data 31/08/2007.

2.1 Të mësuarit nga përvojat dhe të dhënat në të kaluarën

Për të ndërtuar një qasje diagnostike për mbledhjen e të dhënave mbi krimet nga urrejtja dhe një sistem të qëndrueshëm monitorimi, Komiteti i Helsinkit kryesisht mbështetet në përvojat e mëparshme, nga të cilat zhvillojmë praktikatat më të mira për shfrytëzimin e rezultateve. Nga ana tjetër, mbledhja e të dhënave është hapi i parë drejt luftimit të krimeve nga urrejtja, pasi të dhënat e besueshme dhe statistikatat janë të nevojshme për të zhvilluar politika të synuara dhe mbështetje individuale viktimave.⁶ Prandaj është thelbësore që të bazohemi në punën e viteve të kaluara në terren dhe si rrjedhojë, para hartimit të këtij raporti janë konsultuar edhe raportet për vitin 2013⁷, 2014⁸, 2015⁹, 2016¹⁰, 2017¹¹, 2018¹² dhe 2019¹³.

2.2 Mirëmbajtja e një faqe interaktive interneti për raportimin e krimeve të urrejtjes

Portali – www.zlostorstvaodomraza.com, që prej vitit 2014 gjithashtu i aksesueshëm edhe në www.zlostorstvaodomraza.mk, është një vegël interaktive që informon qytetarët për krimet nga urrejtja dhe lejon përdoruesit të raportojnë incidente. Përmban një hartë interaktive që tregon vendndodhjen e saktë apo të përafërt të incidenteve. Faqja kryesore rendit kategoritë e krimeve të urrejtjes dhe ato me motive të njëanshme, ofron informacion në lidhje me mënyrat se si qytetarët mund të raportojnë incidente, përmes aplikacioneve elektronike, Twitter-it, email-it dhe formularëve online dhe prezanton të dhëna statistikore përmes grafikëve. Ekzistojnë gjithashtu tabulatorë për Pyetjet më shpesh të parashtruara, Burimet dhe Fjalor termash në portalin elektronik, nën të cilin publikohen rregullisht informacione dhe botime në lidhje me projektin, kuptimin dhe përmasat e krimeve nga urrejtja.

Gjatë vitit 2020, ekipi i projektit ka përditësuar të gjitha funksionet dhe dizajnin e faqes së internetit. Përpos portalit, faqja në Facebook dhe llogaria në Twitter rregullisht shpërndajnë informata relevante rreth situatës me krimet nga urrejtja në vendin tonë. Të gjitha materialet janë në dispozicion në maqedonisht, shqip dhe anglisht. Është e rëndësishme të theksohet se numri i ndjekësve në Facebook dhe Twitter është gjithnjë në rritje, gjë që tregon se më shumë njerëz po shfaqin interes për këto çështje.

6 Kjo qasje është ndarë edhe me Zyren për institucione demokratike dhe të drejta të njeriut (ODIHR).

7 Helsinki Committee for Human Rights, Hate crimes in the Republic of Macedonia in 2013, published 15 May 2014, available at: <http://shorturl.at/fhATY>.

8 Helsinki Committee for Human Rights, Hate crimes in 2014, published 22 July 2015, available at: <http://shorturl.at/mnqL1>, English version starts from page number 139.

9 Helsinki Committee for Human Rights, Hate crimes in 2015, published 22 July 2016, available at: <http://shorturl.at/ATZ39>.

10 Helsinki Committee for Human Rights, Hate crimes in 2016, published 24 July 2017, available at: <http://shorturl.at/tvBC4>, English version starts from page number 115.

11 Helsinki Committee for Human Rights, Hate crimes in 2017, published 26 February 2018, available at: <http://shorturl.at/qN169>.

12 Helsinki Committee for Human Rights, Hate crimes in 2018, published 10 September 2019, available at: <http://shorturl.at/dwylW>.

13 Helsinki Committee for Human Rights, Hate crimes in 2019, published 22 July 2020, available at: <http://shorturl.at/dlyP8>.

2.3 Monitorimi i mediave kombëtare të shkruara dhe elektronike

Komiteti Helsinki në vitin 2020 ka vazhduar së monitoruari një numër të gazetave ditore me prirje të ndryshme ideologjike dhe përkatësi politike. Monitorimi i mediave elektronike është bërë në bazë ditore, përmes dy gjeneruesve më të njohur të lajmeve në internet (www.time.mk dhe www.grid.mk), si dhe përmes opsioneve të avancuara të kërkimit nën seksionin 'News' në www.google.com. Kur të regjistrohet një krim ose incident nga urrejtja, Komiteti i Helsinkit do ta publikonte në portalin për raportimin e krimeve nga urrejtja – www.zlostorstvaodomraza.mk. Qëllimi kryesor i monitorimit të mediave është të identifikojë dukuri të mundshme të incidenteve të urrejtjes dhe të kontaktojë viktimat e pretenduara për një intervistë dhe t'u ofrojë atyre ndihmë të mundshme juridike ose të monitorojë proceset e tyre gjyqësore. Duke vepruar në këtë mënyrë, Komiteti ka regjistruar dhe publikuar 104 krime/incidente të urrejtjes për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2020. Rënia e konsiderueshme e incidenteve të regjistruara (104) krahasuar me vitin 2019 (159), me shumë gjasë lidhet me rrethanat e jashtëzakonshme të imponuara nga pandemia dhe shtetrrëthimet e shumta gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, por kjo do të shtjellohet më tej në kapitullin Përmbledhje e gjetjeve kryesore.

2.4 Raportimi dhe kontrolli i dyfishtë i krimeve dhe incidenteve të urrejtjes me Misionin e OSBE-së në Shkup

Detajet rreth incidenteve (përshkrim i shkurtër, data, koha, vendndodhja, burimi i informacionit, viktimat e përfshira, autorët e krimeve, statusi i rastit, përgjigja e institucioneve dhe ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin) rregullisht janë raportuar në Misionin e OSBE-së në Shkup. Monitorimi i rasteve në pjesë të madhe ishte lehtësuar nga funksionimi i vazhdueshëm dhe me sukses i platformës online për vënien në hartë të krimeve nga urrejtja. Përpos mundësisë së monitorimit online të incidenteve nga urrejtja pasi të kenë ndodhur, Misioni i OSBE-së në Shkup ka pranuar edhe raporte të përkohshme dhe përfundimtare të përgatitura nga Komiteti i Helsinkit. Këto konkluzione do të ndahen gjithashtu me OSBE/ODIHR për raportin e tyre vjetor për krimet nga urrejtja në vendet anëtare të OSBE-së.

Rezultatet janë prezentuar në përmbledhjen e konkluzioneve kryesore, kurse raporti gjithashtu përmban një aneks i cili shtjellon çdo incident të urrejtjes prej 104 sosh që ndodhën në vitin 2020.

3. REZYME E

GJETJEVE KRYESORE

Gjetjet kryesore për vitin 2020 janë përmbledhur përmes kategorozimit të të dhënave në tetë kategori.

3.1 Konteksti

Pasi Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut nënshkroi dekretin për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme më 18 mars 2020¹⁴, Komiteti i Helsinkit deklaroi publikisht se gjendja e jashtëzakonshme në asnjë mënyrë nuk duhet të jetë justifikim për autoritetet kompetente që të shkelin të drejtat e njeriut. Komiteti ka theksuar se masat që do të merren nuk duhet të devijojnë nga detyrimi për t'i mbrojtur nga dhuna kategoritë më të cenueshme të qytetarëve dhe se të drejtat dhe liritë e njeriut duhet të merren në konsideratë. Shteti është përgjegjës për sigurimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe si i tillë, ai nuk duhet të pengojë në mënyrë arbitrare ushtrimin e të drejtave të njeriut ose të kufizojë arbitrarisht liritë e njeriut gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme. Komiteti i Helsinkit ka këshilluar se në pajtim me standardet e vendit dhe ndërkombëtare, kufizimi i të drejtave dhe lirive nuk duhet në asnjë rast të jetë diskriminues në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, religjionit, etnisë ose prejardhjes sociale, pronës ose statusit social. Ndërhyrja arbitrare do ishte kundër intereseve publike dhe të mirës së përbashkët, kurse aktet juridike të miratuara nga qeveria do ishin në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.

Para se të shpallet gjendja e jashtëzakonshme, Komiteti i Helsinkit riorganizoi punën e vet në pajtim me rekomandimet për parandalim të Ministrisë së Shëndetësisë. Ne kemi ofruar shërbime të pandërprera sa i përket ndihmës juridike për qytetarët përmes telefonit dhe e-mailit, duke lënë mundësi për takime direkte në raste të emergjencës, në mënyrë që të mund të dëgjojmë nga dora e parë qytetarët duke ndarë përvojat e tyre përkatëse. Teksa kufizimet në lirinë e lëvizjes dhe kriza ekonomike nënkuptonin një goditje të pashmangshme për të drejtat e njeriut, Komiteti ka qëndruar i fokusuar në çështjet e krimeve nga urrejtja. Megjithëse 95 ditët e gjendjes së jashtëzakonshme,¹⁵ si dhe shtettrëthimet e numërta kanë kontribuar në uljen e numrit të krimeve nga urrejtja, prevalenca e raportimit të këtyre veprave në vend mbeti e lartë gjatë gjithë vitit.

Duke marrë parasysh se Raporti i progresit i Komisionit Evropian për vitin 2020 për vendin thoshte se "Kishte vazhduar trendi në rritje i rasteve të veprave nga urrejtja, të regjistruara në bazën e të dhënave të shoqërisë civile ...",¹⁶ dhe se "Nevojiten përpjekje për të rritur kapacitetin e autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe profesionistëve ligjorë për të parandaluar dhe ndjekur penalisht të gjitha rastet e dhunës, krimet nga urrejtja dhe gjuhën e urrejtjes në mënyrë më efektive."¹⁷, por ne duhet

14 Vendim që shpall ekzistencën e gjendjes së jashtëzakonshme të datës 18.3.2020 nga Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 68/2020).

15 Vendimi i parë u ndoq nga 4 të tjerë. Vendimi me datë 17.4.2020 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 104/2020), Vendimi me datë 17.4.2020 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 127/2020), Vendimi me datë 17.5.2020 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 142/2020) dhe Vendimi me datë 15.6.2020 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 159/2020).

16 Komisioni Evropian, Raporti 2020 Maqedonia e Veriut, Bruksel, tetor 2020, fq. 32.

17 Komisioni Evropian, Raporti 2020 Maqedonia e Veriut, Bruksel, tetor 2020, fq. 34.

të ndajmë mendimin se mund të ishte bërë më shumë gjatë vitit 2020 në këtë drejtim. Duke shtuar këtu edhe Raportin e progresit të Komisionit Evropian për vitin 2019 për vendin, në të cilin thuhej se "mbledhja e të dhënave për gjuhën e urrejtjes nuk është sistematike, ndërsa në bazën e të dhënave të shoqërisë civile u vu re një rritje e rasteve të krimeve nga urrejtja",¹⁸ duket se ekziston një trend në zhvillim për të shpërfillur problemet në këtë sferë. Është gjithashtu e rëndësishme të përmendet se analiza e veçantë e krimeve të urrejtjes të regjistruara në vitin 2013, raportet vjetore mbi veprat nga urrejtja në vend ndërmjet viteve 2014 dhe 2020, si dhe portali online për raportimin e krimeve nga urrejtja – www.zlostorstvaodomraza.mk, përfaqësojnë një përpjekje të vetme dhe shumë të gjerë për të vënë në hartë, monitoruar dhe raportuar incidentet e urrejtjes në vend.

Megjithatë, ka edhe aspekte pozitive të punës në fushën e luftimit të krimeve të urrejtjes; disa prej tyre janë:

- fakti se më shumë se 2.000 policë janë trajnuar për të identifikuar krimet nga urrejtja ndërmjet viteve 2015 dhe 2016;
- përmirësimet në sistemin automatik të bazës së të dhënave në prokurori dhe gjykata, të cilët tash kanë një buton opsional për regjistrimin e krimeve të urrejtjes;
- ndryshimet në Kodin Penal të miratuara në dhjetor të vitit 2018 që qartësuan dispozitat për krimet nga urrejtja dhe zgjeruan bazat për mbrojtje në praktikë; dhe
- përmirësimet në mbledhjen e të dhënave për krimet nga urrejtja në nivel kombëtar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Përpos kësaj, mbetet perceptimi i përgjithshëm se identifikimi adekuat dhe në kohë dhe regjistrimi i krimeve të urrejtjes nga ana e policisë dhe autoriteteve ligjore është ende nivel të pakënaqshëm. Duhet të përmendet se pas një rritjeje të incidenteve të regjistruara në vitin 2018 nga MolA (gjithsej 33), krahasuar me periudhën midis viteve 2014 dhe 2017,¹⁹ kur ishin regjistruar gjithsej vetëm 7 incidente,²⁰ autoritetet shtetërore për vitin 2019 kishin raportuar vetëm 23 incidente.²¹ Kriza shëndetësore është larg përfundimit, kurse kriza ekonomike dhe sociale do të intensifikohet me kalimin e çdo dite të pasigurisë dhe kufizimeve të imponuara. Prandaj, shpresojmë që ky raport, si dhe raporti i veçantë,²² të shërbejnë si udhëzues veprimet e mëtejshme të vendim-marrësve, sepse përcaktojnë me saktësi se të drejtat e kujt kanë pësuar më së shumti në periudhën kritike që kaluam dhe ku duhet të bëhen ndërhyrje urgjente dhe efektive për të parandaluar dëmet e mëtejshme.

18 Komisioni Evropian, Raporti 2020 Maqedonia e Veriut, Bruksel, tetor 2020, fq. 30.


19 Nuk kishte incidente të raportuara në vitet 2014 dhe 2017, në vitin 2015 ishin regjistruar 5 incidente dhe 2 incidente në vitin 2016. Për më shumë shih: <http://hatecrime.osce.org/north-macedonia>.

20 Në vitin 2015, vendi ka publikuar statistika për 5 krime të urrejtjes, të raportuara nga policia, 3 prej të cilëve ishin të proceduar, përderisa për 2 sosh kishte shqiptim dënimi.

21 Për më shumë shih: <http://hatecrime.osce.org/north-macedonia>.

22 Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Raport i veçantë për situatën me të drejtat e njeriut në Maqedoninë e Veriut gjatë COVID-19, publikuar më 13 tetor 2020.

3.2 Numri i incidenteve



Në vitin 2020, Komiteti ka regjistruar gjithsej 104 incidente dhe krime të urrejtjes. Incidentet janë regjistruar menjëherë pasi ata ishin raportuar nga mediat ose nga Ministria e Punëve të Brendshme. Në të njëjtën kohë, ishin verifikuar 37 incidente (36%), përderisa 67 (64%) mbetën të paverifikuara. Shumica e rasteve të paverifikuara kanë të bëjnë me situata ku sipas indikatorëve/treguesve të tjerë,²³ ekziston një besim i arsyeshëm se këto janë incidente të njëanshme të motivuara nga përkatësia etnike e viktimës. Përkundër kërkesave tona për të konfirmuar indikatorët, Ministria ende nuk i ka verifikuar këto vepra/incidente të urrejtjes.

Shumica e incidenteve ishin konfirmuar duke kontrolluar buletinet policore dhe mediat që raportojnë rastet. Sidoqoftë, incidentet e paverifikuara janë përfshirë në këtë raport për shkak të prezencës së indikatorëve të anshmërisë, duke përfshirë:

- Perceptimin e viktimës/dëshmitarit;
- Komentet e bëra në vendngjarje;
- Përkatësinë e ndryshme etnike të viktimës dhe autorit;
- Modelin/frekuencën e incidenteve të mëparshme;
- Natyrën e dhunës;
- Mungesën e motiveve të tjera; dhe
- Vendndodhjen dhe kohën.

Konkretisht, incidentet e paverifikuara janë përfshirë për shkak të informacionit të marrë në lidhje me vendngjarjen,²⁴ llojin,²⁵ kohën,²⁶ dhe pronën e dëmtuar gjatë incidentit.²⁷ Incidentet e paverifikuara dhe të verifikuara mund të shihen ndaras në portalin online për raportimin e krimeve të urrejtjes, rastet e verifikuara janë të shënuara me një sfond teksti të gjelbër, ndërsa ato të paverifikuara me një sfond teksti të kuq .

23 Vendndodhja, mënyra e kryerjes, përfshirja e personave të mitur dhe nxënësve të shkollave të mesme.

24 P.sh, lagje ose shkollë etnikisht e përzier, linja autobusi të përdorura nga anëtarët e bashkësive të ndryshme etnike, vende ku në të kaluarën kanë ndodhur krime të urrejtjes.

25 P.sh, një grup i madh i të miturve sulmojnë një ose më shumë viktime pa ndonjë provokim, përlëshje në grup, sulme në autobusë ose stacione të autobusëve.

26 P.sh, pas përlëshjeve të mëparshme si formë e hakmarrjes, pas shkollës, gjatë ose pas mbarimit të një ndeshje sportive.

27 P.sh., vende ku mbahen rite fetare.

Përkatësia etnike (76 incidente) dhe përkatësia politike (12 incidente) edhe një herë përfaqësojnë pjesën më të madhe të motiveve, nën të cilat janë kryer këto krime në vitin 2020. Për më tepër, 5 vepra të urrejtjes ishin shënjestruar ndaj migrantëve ose refugjatëve për shkak të statusit të tyre, 4 incidente ishin të motivuara nga kombësia e ndryshme, 3 incidente ndodhën për shkak të besimit fetar, 2 incidente ishin të motivuara nga orientimi seksual, 1 incident ishte në bazë të aftësive të kufizuara intelektuale dhe 1 incident ishte i bazuar në gjini. Viktimat dhe autorët zakonisht janë të rinjë dhe anëtarë të grupeve të ndryshme etnike.²⁸ Shpesh një incident i vetëm i përmbush kriteret e dy ose më shumë veprave të supozuara, prandaj ka numër më të madh veprash sesa incidentesh. Shumica e incidenteve që ndodhin për shkak të përkatësisë ose bindjes politike nuk përfshijnë persona si viktima, por përkundrazi, viktima paraqiten personat juridikë. Kjo për faktin se shumica e këtyre incidenteve i referohen dëmtimit të pronës dhe shkakimit të dëmeve materiale.

Shumica e krimeve të supozuara përfshijnë: dhunë (66), lëndime trupore dhe lëndime të rënda trupore (8), nxitje të urrejtjes etnike, racore ose fetare, përçarje dhe intolerancë (8), grabitje (7), dëmtim i pronës (5), kërcënim serioz (4), gjymtim simbolesh (3) dhe kërcënim i sigurisë (3). Detajet e incidenteve, siç janë përshkrimi i shkurtër, data, koha, vendndodhja, burimi i informacionit, viktimat e përfshira, autorët e veprave, statusi i rastit, përgjigja e autoriteteve, ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit mund të gjenden në Aneksin e këtij raporti me titull “Incidente nga urrejtja në vitin 2020”. Në të njëjtin Aneks, ka një fushë për ‘indiktorët e anshmërisë’, që përfshihet në çdo incident të veçantë. Ajo përfshin të dhëna mbi perceptimin e viktimave/dëshmitarëve; komentet e bëra në vendngjarje; dallimin midis viktimës dhe autorit të krimit sipas përkatësisë etnike; modelin/frekuencën e incidenteve të mëparshme; natyrën e dhunës; mungesën e motiveve të tjera, vendndodhjen dhe kohën. Përveç se ofron informacion shtesë rreth incidentit, kjo fushë është veçanërisht e dobishme për të kuptuar pse incidentet e paverifikuara janë përfshirë gjithashtu në këtë raport.

Në mars të vitit 2020, Komiteti i Helsinkit i dorëzoi OSBE/ODIHR-it Raportin vjetor për krimet nga urrejtja për vitin 2019.²⁹ Komiteti i Helsinkit është organizata e vetme joqeveritare që informon OSBE/ODIHR-in për situatën e krimeve nga urrejtja në vend. Tendanca e rritjes së numrit të incidenteve të urrejtjes të konstatuara në vitin 2018, e që vazhdoi edhe në vitin 2019, këtë vit duket se ka rënë ndjeshëm. Sidoqoftë, situata me KOVID-19 ka ndikuar gjithashtu në këtë aspekt të jetës dhe për momentin është e pamundshme të parashikohen saktë arsyet e kësaj rënie në vitin 2020.

Me vetëm 12 incidente të regjistruara për shkak të përkatësisë dhe bindjes politike mund të thuhet se numri i incidenteve me motive të njëanshme politike, pas disa vitesh ka pësuar rënie.³⁰ Kjo për shkak të zgjidhjes së problemeve të shumta afatgjatë të brendshme dhe jashtme politike. Incidentet në vitin 2020 në këtë sferë kryesisht kanë përfshirë dëmtim pronash të LSDM/VMRO-DPMNE-së ose kërcënime serioze ndaj anëtarëve dhe simpatizantëve. Duke marrë parasysh intensifikimin e incidenteve në janar të vitit 2019, menjëherë pas votimit të ndryshimeve kushtetuese për zbatimin e Marrëveshjes së Prespës të vitit 2018, dhe në prill para dhe gjatë zgjedhjeve presidenciale, si dhe në fund të vitit, menjëherë pas shpalljes së zgjedhjeve parlamentare për muajin prill të vitit 2020, këtë vit nuk kishte kësaj periudhash të vecanta që krimet e urrejtjes për shkak të përkatësisë politike të arrinin kulmin. Për më tepër, serioziteti i këtyre incidenteve nuk është i krahasueshëm me ato ndërmjet viteve 2016 dhe 2019. Ky kurs nuk ndjek trendet e viteve të mëparshme kur këto lloje

²⁸ Kryesisht midis maqedonasve dhe shqiptarëve.

²⁹ Shih: <http://hatecrime.osce.org/north-macedonia>.

³⁰ Përfshirë edhe vitin e kaluar.

incidentesh ishin në rritje para dhe gjatë zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në vitin 2014, zgjedhjeve parlamentare po atë vit, zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në vitin 2016, si dhe zgjedhjeve lokale në vitin 2017, ndërsa këtë vit numri ka mbetur në të njëjtin kufi ndërmjet 1 dhe 2 në muaj, madje edhe në periudhën para zgjedhjeve parlamentare të muajit korrik. Sidoqoftë, duke marrë në konsideratë kufizimet e vendosura për shkak të KOVID-19 dhe qasjen drastikisht të ndryshme ndaj fushatave politike, nuk është e mundur të dallohet në këtë pikë nëse atmosfera e përgjithshme në vend në këtë aspekt është përmirësuar.

Trendi i dytë i dukshëm lidhet me numrin e incidenteve bazuar në përkatësinë etnike maqedonase apo shqiptare të autorit/viktimës. Në vitin 2013, këto incidente kanë arritur 84% të incidenteve (98 nga 116), kurse në vitin 2014 kjo përqindje ishte 61% (53 nga 87). Gjatë vitit 2015 vetëm 36% e incidenteve (16 nga 44) kanë ndodhur midis maqedonasve dhe shqiptarëve,³¹ në 2016 – 49% të incidenteve (34 nga 70),³² dhe në vitin 2017 – 29 incidente (41%).³³ Në vitet e fundit nuk kishte rënie të konsiderueshme të këtyre llojeve të incidenteve, dhe ata kanë mbetur çështja më sfiduese, madje edhe më shumë nëse kemi parasysh se një pjesë e madhe e viktimave dhe autorëve në këto incidente janë të mitur. Në vitin 2018, numri i incidenteve të regjistruara nga urrejtja bazuar në përkatësinë etnike është rritur përsëri në 64% (79 nga 123) të të gjitha incidenteve të regjistruara. Në vitin 2019, 85% e të gjitha incidenteve të regjistruara (135 nga 159) kanë ndodhur për shkak të përkatësisë etnike të viktimave/autorëve, duke i bërë këto incidente më të zakonshmet dhe më shqetësueset si në të kaluarën (2013/2014). Duke marrë parasysh këtë, rënia në 73% këtë vit mund të shihet si një rënie e konsiderueshme, por edhe një herë, për shkak të kufizimeve të vendosura nga KOVID-19, dhe qasjen drastikisht të ndryshme ndaj fushatave politike, nuk është e mundur të dallohet në këtë pikë nëse atmosfera e përgjithshme në vend në këtë aspekt është përmirësuar.

Pas disa viteve, dhe për herë të dytë me rradhë, 2 incidente të pavarura të motivuara nga orientimi seksual/identiteti gjinor i viktimës janë regjistruar. Kjo potencialisht mund të nënkuptojë se bezimi në institucionet është rritur në mesin e komunitetit LGBTI për shkak të mesazheve pozitive dhe përkrahjes publike të ofruar nga partija qeveritare dhe disa prej figurave publike politike. Mirëpo, ky fakt nuk do të thotë domosdoshmërisht se shoqëria është bërë më tolerante ndaj komunitetit LGBTI. Në këtë aspekt, duhet të merret parasysh se autoritetet shtetërore dështuan së hetuari në mënyrë adekuate incidentet prej 2013 dhe 2014, dhe policia dështoj së arrestuari ndonjë prej kryerësve përsëri këtë vit.

Ndryshimet e krimeve të urrejtjes në Kodin penal që u miratuan në dhjetor të 2018, që erdhën në fuqi më 8 janar 2019. Kjo është një ndryshim legjislativ shumë i rëndësishëm dhe si rezultat i kësaj duhet të ketë një rritje në prokurimin penal të krimeve të urrejtjes. Kjo është viti i parë i implementimit dhe prandaj është akoma shumë herët që të arrihen konkludime, por është e rëndësishme të merret


31 Krahësuar me incidentet e regjistruara në 2013 dhe 2014, ndryshimi më i madh ka të bëjë me viktimat, pasi shumica e tyre ishin refugjatë ose migrantë. Në fund të vitit 2014 dhe në 2015 një numër i paparë refugjatësh kanë kaluar nëpër vend në një përpjekje për të hyrë në zonën Shengen të BE-së. Gjithsej 21 nga 44 incidente (48%) në 2015 ishin të lidhura me sulme ose grabitje (përfshirë grabitje me armë) të refugjatëve ose migrantëve gjatë tranzitimit të vendit. Në kohën e këtyre incidenteve, të paktën 62 (pothuajse 50% e të gjitha viktimave të regjistruara) sirianë, afganë, iranianë dhe marokenë ishin viktimat të krimit të urrejtjes. Shikoni Raportin vjetor të krimeve të urrejtjes për vitin 2015.

32 2016 dhe 2017 u karakterizuan nga një krizë serioze politike dhe shumë dhunë midis partive politike. Për më shumë shikoni Raportin vjetor për krimet e urrejtjes për 2016 dhe 2017.

33 Në vitin 2017, llojet e përmendura të incidenteve u bënë më të shpeshta pas dështimit të VMRO-DMPNE për të siguruar një shumicë prej të paktën 61 deputetëve në periudhën e përcaktuar nga kushtetuta dhe gjatë negociatave për formimin e qeverisë. Gjatë vitit, numri i krimeve të urrejtjes të kryera në bazë të përkatësisë politike ose bindjes politike u rrit përsëri para fushatës zgjedhore lokale, duke konfirmuar marrëdhënien e drejtpërdrejtë shkak-pasojë midis gjuhës së urrejtjes të përdorur gjerësisht në fushatat zgjedhore dhe krimeve të mëpasshme të urrejtjes. Shikoni Raportin vjetor për vitin 2017.


parasysh se shteti ka raportuar 23 incidente për vitin 2019. Kjo është një rrënie e habitshme duke konsideruar se kishte një rritje oficalisht e regjistruar e incidenteve nga ana e MolA, i.e. në 2018, 33 krime të urrejtjes ishin të regjistruara nga policia, përderisa në 2017 asnjë incident nuk është raportuar, 2 incidente u raportuan në 2016 dhe 5 sihin të raportuar në 2015.³⁴

3.3 Lloji i veprave penale



Shumica e incidenteve janë kryer nga të rinjtë dhe ka gjithashtu një numër të madh të autorëve të panjohur. Viktimat dhe autorët zakonisht janë anëtarë të komuniteteve të ndryshme etnike,³⁵ kurse incidentet e raportuara kishin lidhje me disa prej veprave penale të përfshira në Kodin Penal. Shumica e krimeve të supozuara përfshijnë: dhunë (66), lëndime trupore dhe lëndime të rënda trupore (8), nxitje e urrejtjes, përçarjes dhe intolerancës etnike, racore dhe fetare (8), grabitje (7), dëmtim i pronës (5), kërcënim serioz (4), gjymtim i simboleve (3) dhe kërcënim i sigurisë (3). Zakonisht një incident i përmbush kriteret për dy ose më shumë vepra të pretenduara penale, dhe për këto arsye mund të ketë një numër më të madh të veprave penale sesa numri i të dhënave të incidenteve.³⁶

3.4 Incidentet sipas vendndodhjes




34 Për më shumë: <http://hatecrime.osce.org/north-macedonia>.

35 Shumica, por jo vetëm: maqedonas dhe shiptarë.

36 Krimet e urrejtjes rregullohen nga Kodi Penal, ndërsa incidentet përfshijnë një gamë më të gjerë të çështjeve që përfshijnë vepra të tilla si mbishkrime të urrejtjes, brohoritje nacionaliste etj.

Shumica e incidenteve - 72 (69,2% e të gjithë regjistruarve) - ndodhën në Shkup dhe komunat përreth tij. Kishte 7 incidente në Kumanovë; 5 në Manastir; 4 në Ohër; 3 në Tetovë; 2 në Kërçovë, Veles, Strugë dhe Prilep; 1 incident në Krushevë, Koçanë, Dellçevë dhe Strumicë dhe vendndodhja për 1 incident nuk dihet.


Shumica e qyteteve gjenden në rajone ku jetojnë një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve etnikë (Shkup, Kumanovë, Kërçovë dhe Strugë), maqedonasve etnikë (Tetovë dhe Gostivar), vlllehëve etnikë (Krushevë) ose pakica të tjera që së bashku përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullatës (Manastir, Ohër, Strumicë dhe Koçanë). Dibra është një prej qyteteve të rralla ku maqedonasit dhe shqiptarët jetojnë bashkë që nuk regjistroi asnjë krim të urrejtjes në vitin 2020.



Incidentet në Shkup dhe në afërsi të tij përsëri përfshinë shumicën e sulmeve midis anëtarëve të grupeve etnike maqedonase dhe shqiptare dhe dëmtimin e pasurisë së partive politike. Sipas përqindjes, këto incidente më shumë janë të përfaqësuara në Komunën e Gazi Babës me 18%. Ndër të tjera, incidente të tilla janë regjistruar në të gjithë 9 komunat e Shkupit: Aerodrom dhe Çair 14%, Qendër 12%, Butel, Gjorçe Petrov dhe Kisella Vodë 10%, dhe Karposh, Shuto Orizarë dhe Saraj 4%. Fakti se disa komuna regjistrojnë më pak incidente, nuk çojnë në përfundimin se ato incidente ndodhin më rrallë atje, por se ata nuk janë denoncohen rregullisht. Komuna e Shuto Orizarës është kryesisht e populluar me romë etnikë, Çairi dhe Saraji me shqiptarë etnikë, përderisa maqedonasit etnikë janë shumicë në komunat e tjera. Shumë nga incidentet në Shkup kanë ndodhur në autobuse,³⁷ duke udhëtuar nëpër lagje që janë të banuara nga maqedonas dhe shqiptarë. Incidentet e tjera përfshinë një sulm të një grupi studentësh kundër një studenti tjetër ose përleshje midis dy grupeve kundërshtarë.


³⁷ Ndonjëherë mediat thonë se vendngjarja është një autobus, por nuk e zbulojnë numrin e autobusit.

3.5 Incidentet sipas muajve



Numri më i lartë i incidenteve ka ndodhur në muajin gusht (11). 10 incidente kishte në muajt shkurt, prill, qershor, korrik dhe tetor, 8 në muajt janar, maj dhe dhjetor, 7 në muajt mars dhe nëntor dhe 5 në muajin shtator (numri më i ulët). Edhe pse zakonisht ka tendenca për muaj me numër më të madh krimesh nga urrejtja, këtë vit nuk kishte periudha të tilla.³⁸

3.6 Incidentet sipas motiveve të njëanshme




Motive të njëanshme

- Përkatësia etnike
- Përkatësia politike
- Statusi i migrantit ose refugjatit
- Shtetësia
- Besimi dhe bindja fetare
- Orientimi seksual
- Aftësitë e kufizuara
- Gjinia

Përkatësia etnike (76 incidente) dhe përkatësia politike (12) përfaqësojnë numrin më të madh të motiveve nën të cilat janë kryer krimet e urrejtjes në vitin 2020. Për më tepër, 5 krime të urrejtjes ishin shënjestruar ndaj migrantëve ose refugjatëve për shkak të statusit të tyre, 4 incidente ishin të motivuara nga përkatësia e ndryshme etnike e viktimës, 2 incidente ishin të motivuara për shkak të orientimit seksual, 1 incident ishte për shkak të aftësive të kufizuara intelektuale dhe 1 incident ishte me bazë gjinore. Në shumicën e incidenteve ishin të përfshirë maqedonas dhe shqiptarë, edhe si viktima dhe si autorë.

³⁸ Përsëri, ky është një rezultat i masave të vendosura për t'u përballur me pandeminë COVID-19. Megjithatë zgjedhjet parlamentare të vendit u mbajtën në 15 korrik, nuk kishte rritje në muajt para korrikut.

3.7 Viktimat dhe autorët




Gjatë gjithë vitit kishte të paktën 116 viktima (prej të cilave 44 të mitur) dhe 207 (21 të mitur) autorë të krimeve nga urrejtja. Sa herë që mediat raportnin në lidhje me ndonjë numër të pacaktuar, për shembull ndërmjet 10 dhe 15 autorë, për qëllimet e këtij raporti është përdorur numri më i vogël. Sa herë që është raportuar se një 'grup' autorësh ka kryer një krim urrejtjeje, raporti ka përdorur numrin e 3 personave. Në shumicën e incidenteve, autorët kanë vepruar në grup dhe një pjesë e konsiderueshme e viktimave dhe autorëve janë djem të rinj.

3.8 Statusi i rasteve

Duke marrë parasysh se nuk ekziston një bazë të dhënash për krimet e urrejtjes, rastet janë regjistruar duke kontaktuar policinë, monitoruar mediat dhe duke marrë informacion drejtpërdrejt nga viktimat. Për çdo incident të vërtetuar, Komiteti i Helsinkit ka kërkuar informacion nga Ministria e Punëve të Brendshme, për të marrë informacion rreth statusit të rastit. Komiteti ka kërkuar informacion publik nga Ministria në lidhje me të gjitha incidentet e regjistruara, për të cilat mori informacion për të gjithë muajt.

Në përgjigjet,³⁹ u vu re se ata kanë filluar të regjistrojnë disa incidente në mënyrë eksplicite si krime të urrejtjes, 9 prej 104 nga ky raport; megjithatë, kjo ende nuk bëhet rregullisht, por në mënyrë arbitrare. Përkatësisht, këto incidente ishin në lidhje me ngjarje që i referoheshin kërcënimeve ndaj politikanëve përmes internetit dhe rasteve të shpërndarjes së materialit racist dhe ksenofobik përmes sistemeve kompjuterike. Prandaj, shumica e përgjigjeve të marra nga Ministria në lidhje me incidentet e vitit 2020 ishin të pakënaqshme dhe nuk u përgjigjeshin pyetjeve të parashtruara; prandaj, ato nuk përmbanin ndonjë informacion specifik në lidhje me incidentët, por vetëm një e dhënë nëse një ngjarje ishte regjistruar apo jo nga MPB-ja.

³⁹ MPB-ja ka dorëzuar informacion për të gjitha rastet, respektivisht për 104 prej 104 incidenteve të regjistruara.



Prej përgjigjeve u vu re se MPB-ja ka identifikuar 71 autorë prej gjithsej 207 të regjistruar, 9 raste janë nën hetim, 25 kallëzime të ngritura penale dhe MPB-ja ka regjistruar 17 incidente si kundërvajtje kundër rendit publik. Në përgjigjet e tyre ndaj rasteve të dëmtimit të pronës ose varreve, MPB-ja theksoi se këto lloje krimesh janë procesuar me anë të padive private. Në dy raste, viktimat kanë refuzuar të ngrejë asnjë kallëzim. Sidoqoftë, edhe një herë, statusi i numrit më të madh të incidenteve ka mbetur i panjohur.

4. AKTIVITETET E

EKIPIT PROJEKTUES

Aktivitetet janë të dizajnuara të ofrojnë indikatorë për fushëveprimin, natyrën dhe shpeshtësinë e kryerjes së krimeve të urrejtjes në vend. Përmes kësaj qasjeje, ne synojmë të punojmë në parandalimin e krimeve të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes përmes përmirësimit të legjislacionit, rritjes së ndërgjegjësimit të opinionit dhe përmes ndërtimit të kapaciteteve të institucioneve të drejtësisë penale dhe regjistrimit të incidenteve të njëanshme.

4.1 Monitorimi i incidenteve/krimeve të urrejtjes me theks të veçantë të dhunës në sport të motivuar nga njëanshmëria dhe dhuna e bashkëmohatarëve me motive njëanshmërie midis të rinjve

Komiteti Helsinki në vitin 2020 ka vazhduar së monitoruari një numër të gazetave ditore me prirje të ndryshme ideologjike dhe përkatësi politike. Monitorimi i mediave elektronike është bërë në bazë ditore, përmes dy gjeneruesve më të njohur të lajmeve në internet (www.time.mk dhe www.grid.mk), si dhe përmes opsioneve të avancuara të kërkimit nën seksionin 'News' në www.google.com. Kur të regjistrohet një krim ose incident nga urrejtja, Komiteti i Helsinkit do ta publikonte në portalin për raportimin e krimeve nga urrejtja – www.zlostorstvaodomraza.mk.⁴⁰ Siç u përmend më lartë, duke vepruar në këtë mënyrë, Komiteti ka regjistruar dhe publikuar 104 krime/incidente të urrejtjes për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2020.

Fokusi në ngjarjet politike dhe sportive, si dhe dhuna e bashkëmohatarëve dhe dhuna me motive njëanshmërie midis të rinjve, u zhvendos në internet për shkak të shtetrrethimeve të shumta që u vendosën gjatë gjendjes së jashtëzakonshme dhe rrethanave të jashtëzakonshme të pranishme gjatë periudhës së raportimit. Prandaj, këto burime nuk u përdorën si gjatë viteve të kaluara dhe pikat kryesore të thithjes së informacionit ishin mediat elektronike, buletinet ditore të MPB-së dhe përfituesit e ndihmës juridike që kërkuan nga ekipi i juristëve të Komitetit.

4.2 Rishikimi i rasteve të raportuara të urrejtjes dhe kontributi për Raportin vjetor të ODIHR-së mbi krimet dhe incidentet e urrejtjes në rajonin e OSBE-së për vitin 2020

Në mars të vitit 2020, Komiteti i Helsinkit i dorëzoi OSBE/ODIHR-it Raportin vjetor për krimet nga urrejtja për vitin 2019.⁴¹ Komiteti i Helsinkit është organizata e vetme joqeveritare që informon OSBE/ODIHR-in për situatën e krimeve nga urrejtja në vend.

⁴⁰ Shih edhe aktivitetin 4.3 më poshtë.

⁴¹ Shih <https://hatecrime.osce.org/north-macedonia?year=2019>.

4.3 Mirëmbajtja, përditësimi dhe promovimi i faqes së internetit www.zlostorstvaodomraza.com dhe faqeve në Facebook dhe Twitter në maqedonisht, shqip dhe anglisht

Portali – www.zlostorstvaodomraza.com⁴², është një vegël interaktive që informon qytetarët për krimet nga urrejtja dhe lejon përdoruesit të raportojnë incidente. Përmban një hartë interaktive që tregon vendndodhjen e saktë apo të përafërt të incidenteve. Faqja kryesore rendit kategoritë e krimeve të urrejtjes dhe ato me motive të njëanshme, ofron informacion në lidhje me mënyrat se si qytetarët mund të raportojnë incidente, përmes aplikacioneve elektronike, Twitter-it, email-it dhe formularëve online dhe prezanton të dhëna statistikore përmes grafikëve. Ekzistojnë gjithashtu tabulatorë për Pyetjet më shpesh të parashtruara, Burimet dhe Fjalor termash në portalin elektronik, nën të cilin publikohen rregullisht informacione dhe botime në lidhje me projektin, kuptimin dhe përmasat e krimeve nga urrejtja.

Gjatë vitit 2020, ekipi i projektit ka përditësuar të gjitha funksionet dhe dizajnin e faqes së internetit. Përpos portalit, faqja në Facebook dhe llogaria në Twitter rregullisht shpërndajnë informata relevante rreth situatës me krimet nga urrejtja në vendin tonë. Të gjitha materialet janë në dispozicion në maqedonisht, shqip dhe anglisht. Është e rëndësishme të theksohet se numri i ndjekësve në Facebook dhe Twitter është gjithnjë në rritje, gjë që tregon se më shumë njerëz po shfaqin interes për këto çështje. Gjatë gjithë dhjetorit të vitit 2020, faqja në Facebook tregoi një akses prej 201.776 njerëzve ose rreth 10% të popullsisë së Maqedonisë së Veriut.⁴³

4.4 Themelimi i një rrjeti joformal të veprimtarëve/aktivistëve për të monitoruar dhe regjistruar krimet e urrejtjes kundër grupeve specifike të synuara, të tilla si komuniteti LGBT, romët dhe personat me aftësi të kufizuara

Gjatë periudhës së raportimit, Komiteti i Helsinkit mbajti disa takime me përfaqësues të MPB-së. Kishte një marrëveshje të përgjithshme për të bashkëpunuar, kurse pikat kryesore u caktuan nga sekretari shtetëror i MPB-së. Më tej, ekipi i projektit hartoi një listë të organizatave kombëtare të shoqërisë civile, grupeve formale dhe joformale, që punojnë me grupe specifike të synuara. Megjithatë, për shkak të kufizimeve të vendosura nga situata me KOVID-19, ky aktivitet duhej të ndërpritet në këtë fazë të dytë dhe për këtë arsye nuk u zbatua plotësisht gjatë vitit 2020. Aktivitetet do të vazhdojnë gjatë vitit 2021, pasi gjithashtu presim që të shënojmë edhe Ditën ndërkombëtare të viktimave të krimeve të urrejtjes. Në vend të kësaj, të dy aktivitetet u zëvendësuan me iniciativa alternative vitin e kaluar.⁴⁴

4.5 Pjesëmarrja në dy punëtori për rritjen e ndërgjegjësimit dhe ndërtimit të kapaciteteve, të organizuara nga Misioni për parandalimin e krimeve të urrejtjes që përfshijnë të rinjtë, duke prezantuar punën e Komitetit të Helsinkit në fushën e krimeve të urrejtjes

Ekipi i projektit ka marrë pjesë në të dy punëtoritë. I prezantuam gjetjet kryesore të projektit midis viteve 2013 dhe 2020 dhe kemi diskutuar incidentet e mëparshme të krimeve të urrejtjes.

42 Që nga viti 2014 i aksesueshëm edhe në www.zlostorstvaodomraza.mk.

43 Ky seksion përsëritet sepse është pjesë e metodologjisë dhe aktivitetit të projektit.

44 Shih më poshtë aktivitetet 4.10 dhe 4.11.

4.6 Përgatitja e buletineve mujore për situatën me krimet e urrejtjes në vend

Gjatë periudhës së raportimit, Komiteti i Helsinkit ka përgatitur 12 buletine mujore për çdo muaj.⁴⁵ Ata u publikuan në faqen e internetit të Komitetit, faqen e projektit dhe faqen 'Zlostorstva od omraza' në Facebook.⁴⁶ Të dhënat e zbërthyera sipas muajve janë në dispozicion në lidhjet e mëposhtme:

1. [January bulletin](#), i publikuar më 20 shkurt;47
2. [February bulletin](#), i publikuar më 20 mars;48
3. [March bulletin](#), i publikuar më 20 prill;49
4. [April bulletin](#), i publikuar më 15 maj;50
5. [May bulletin](#), i publikuar më 15 qershor;51
6. [June bulletin](#), i publikuar më 15 korrik;52
7. [July bulletin](#), i publikuar më 15 gusht;53
8. [August bulletin](#), i publikuar më 20 shtator;54
9. [September bulletin](#), i publikuar më 15 tetor;55
10. [October bulletin](#), i publikuar më 15 nëntor;56
11. [November bulletin](#), i publikuar më 10 dhjetor;57
12. [December bulletin](#), i publikuar më 10 janar;58

Komiteti i Helsinkit ka përfshirë edhe një seksion të veçantë të gjuhës dhe krimeve të urrejtjes në raportet e tij mujore mbi situatën me të drejtat e njeriut, të cilët u shpërndahen institucioneve shtetërore, mediave, OJQ-ve, aktorëve të tjerë të rëndësishëm, partnerëve rajonalë, organizatave ndërkombëtare dhe ambasadave të huaja në vend.

4.7 Përgatitja, përkthimi dhe publikimi i raportit të monitorimit për vitin 2020 në maqedonisht, shqip dhe anglisht

Ky raport vjetor është përgatitur, përkthyer dhe publikuar online në faqen e internetit të Komitetit të Helsinkit dhe në portalin zlostorstvaodomraza.com gjatë muajve janar dhe shkurt 2021. The hard copy, just as it was the case with the previous Annual Reports, will be sent by post to all relevant institutions, media, and organizations.

Sa i përket Raportit vjetor të krimeve të urrejtjes për vitin 2019, versioni elektronik u është dërguar mbi 200 institucioneve, mediave dhe organizatave, ndërsa versioni i shtypur në letër iu është dërguar me postë 27 gjykatave themelore dhe 4 të apelit, Gjykatës së Lartë, 22 zyrave të prokurorive themelore publike dhe

45 Pasqyra mujore për krimet nga urrejtja.

46 Krime të urrejtjes

47 I disponueshëm në këtë lidhje: <http://shorturl.at/ijlJN>.

48 I disponueshëm në këtë lidhje: <http://shorturl.at/qsDhV>.

49 I disponueshëm në këtë lidhje: <http://shorturl.at/cdwM1>.

50 I disponueshëm në këtë lidhje: <http://shorturl.at/nvGK5>.

51 I disponueshëm në këtë lidhje: <http://shorturl.at/vALN7>.

52 I disponueshëm në këtë lidhje: <http://shorturl.at/czCHl>.

53 I disponueshëm në këtë lidhje: <http://shorturl.at/gioLV>.

54 I disponueshëm në këtë lidhje: <http://shorturl.at/jGJK9>.

55 I disponueshëm në këtë lidhje: <http://shorturl.at/rvER0>.

56 I disponueshëm në këtë lidhje: <http://shorturl.at/cizE8>.

57 I disponueshëm në këtë lidhje: <http://shorturl.at/pvL08>.

58 I disponueshëm në këtë lidhje: <http://shorturl.at/cyDGJ>.

4 zyrave të prokurorive të larta, Prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 37 institucioneve dhe 11 organizatave.

4.8 Shënimi i Ditës së propozuar të viktimave të krimeve të urrejtjes, 22 korrik, duke organizuar një konferencë shtypi dhe eventin 'Turlitava'

Për shkak të kufizimeve të vendosura nga pandemia KOVID-19 dhe masat e miratuara për parandalimin e përhapjes së virusit, ky aktivitet, bashkë me pjesë të aktivitetit 4.4,⁵⁹ nuk u zbatuan këtë vit. Shpresojmë që gjatë vitit 2021, do të kemi mundësi të vazhdojmë me zbatimin e këtyre dy aktiviteteve. Sa i përket këtij viti, të dy aktivitetet u zëvendësuan me aktivitete alternative.⁶⁰ Sidoqoftë, për të shënuar 22 korrikun,⁶¹ Komiteti i Helsinkit lëshoi një deklaratë shtypi në përkujtim të ditës, dhe gjithashtu botuam Raportin vjetor për krimet e urrejtjes në vitin 2019. Në lidhje me këtë, mediat botuan 43 artikuj në maqedonisht dhe shqip.

Në kushte të rregullta, eventi i 22 korrikut është një tubim gjysmë ditor i quajtur 'Turlitava - një event që përfshin fjalime, muzikë dhe shoqërim të pjesëmarrësve me përkatësi të ndryshme etnike, duke shijuar ushqime tradicionale maqedonase, shqiptare, turke, rome, serbe, boshnjake, kroate dhe vllahe, të tilla si Turlitava - një pjatë tradicionale ballkanike. Ky aktivitet synon të festojë tolerancën dhe bashkëjetesën paqësore midis qytetarëve të bashkësive të ndryshme në vend.

4.9 Ofrimi i ndihmës juridike viktimave të incidenteve të urrejtjes dhe monitorimi i proceseve gjyqësore të rasteve të zgjedhura të krimeve të urrejtjen për disa çështje të mbrojtjes

Në periudhën ndërmjet janarit dhe qershorit, Komiteti i Helsinkit ka ofruar ndihmë juridike në tre raste. Dy raste në lidhje me dy incidente të pavarura në shkurt, ku djem të rinj romë ishin shënjestruar dhe poshtëruar në mjetet e transportit publik për shkak të përkatësisë së tyre etnike. Në të dy rastet, Komiteti i Helsinkit ka ngritur kallëzime penale në Prokurorinë Publike. Rasti i tretë ishte në lidhje me një sulm kundër një djaloshi të ri për shkak të ngjyrës së tij të lëkurës dhe racës, i regjistruar në vitin 2019. Siç është raportuar vitin e kaluar, Komiteti bashkë me të ëmën ka ngritur kallëzim penal kundër dy autorëve të panjohur në Prokurorinë Publike në Shkup. Për shkak të kallëzimit të ngritur, të ëmës dhe viktimës u është kërkuar të japin një deklaratë tjetër në lidhje me incidentin para inspektorit policor. Viktima dhe e ëma ishin shoqëruar deri në stacionin policor në Kisella Vodë nga një këshilltar ligjor i Komitetit.

Prej korrikut deri në dhjetor, Komiteti ka ofruar ndihmë juridike në dy raste. Rasti i parë i referohej një burri gej, i cili kishte marrë kërcënime serioze mbi jetën në Facebook për shkak se ishte një anëtar i komunitetit LGBTI dhe se ka mbrojtur të drejtat dhe liritë e anëtarëve të komunitetit në komente. Nga përmbajtja e kërcënimeve që ka marrë, ishte e qartë se kërcënuesi në të kaluarën, jo vetëm verbalisht, por edhe fizikisht kishte sulmuar dhe ngacmuar anëtarë të komuniteteve të marginalizuara. Ekipi i Komitetit të Helsinkit, së bashku me viktimën, ka ngritur kallëzim penal në stacionin policor 'Qendër' – SP 'Beko' bazuar në nenin 144 të Kodit Penal për veprën penale 'Cenim i sigurisë', me theks të veçantë në paragrafin 2 si formë e kualifikuar e aktit të kryer nga urrejtja. Në vend që provat e siguruara të ishin bazë për nëpunësit policorë për të vepruar me një padi penale duke kontaktuar një prokuror përgjegjës dhe një inspektor të krimit kibernetik, nëpunësit policorë morën rolin e prokurorit, duke interpretuar ligjin vetë, duke argumentuar se rasti duhet të regjistruar si një ankesë e thjeshtë dhe viktima të kërkojë më tej mbrojtje ligjore në një proces gjyqësor civil. Ky vullnetarizëm i punonjësve të policisë nuk është i ri. Përkundrazi, kur raportohet një seri e

⁵⁹ Krijimi i një rrjeti joformal të aktivistëve për monitorimin dhe regjistrimin e krimeve të urrejtjes kundër grupeve specifike të synuara siç janë komuniteti LGBTI, romët dhe personat me aftësi të kufizuara.

⁶⁰ Shih më poshtë aktivitetet 4.10 dhe 4.11.

⁶¹ Dita evropiane e viktimave të krimeve nga urrejtja.

krimeve të urrejtjes, sjellja e nëpunësve policorë është e njëjtë, e pacipë dhe joprofesionale. Sidoqoftë, fakti që viktima ishte këmbëngulës dhe shoqërohej nga një këshilltar ligjor, çoi në inicimin e ndjekjes penale sipas detyrës zyrtare (ex officio).

Rasti tjetër ka të bëjë me një krim të urrejtjes në bazë të aftësisë së kufizuar. Një prind i një fëmije me autizëm raportoi në Komitet se e gjithë familja janë viktima të ngacmimit dhe kërcënimeve serioze nga dy fqinjë në ndërtesën e banesës ku ata jetojnë. Fqinjët kanë trokitur në mënyrë të përsëritur në derën e familjes, duke bërë të qartë se do t'i vrisnin ata dhe fëmijën e tyre 9-vjeçar autik, për të cilin ata po i referoheshin si një personi "të sëmurë mendërisht". Prapavija e këtyre sulmeve është zhurma që pretendohet po shkaktohej nga fëmija. Familja ka raportuar rastin në stacionin policor, por gjithçka kishte përfunduar me një raport policor, pas të cilit nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim i mëtejshëm nga autoritetet për ngacmimin e familjes dhe fëmijës me aftësi të kufizuara intelektuale. Në vitin 2018, policia kishte ngritur kallëzim penal për 'Rrezikim të sigurisë' sipas Nenit 144 të Kodit Penal, por ishte refuzuar nga Prokuroria Publike sepse ngjarja specifike nuk plotësonte elementët e një krimi që duhet ndjekur zyrtarisht (ex officio). Sipas udhëzimeve ligjore të Prokurorisë Publike, kundër fqinjëve, familja kishte ngritur një padi penale private.

Procedimet penale janë planifikuar për në muajin mars të vitit të ardhshëm, të cilat do të monitorohen nga ekipi juridik i Komitetit. Vepra penale e rrezikimit të sigurisë së një fëmije, në bazë të paaftësisë së tij intelektuale, e cila padyshim motivohet nga intoleranca dhe paragjykimi tashmë ekzistues ndaj anëtarëve të këtij grupi të prekshëm, mund të cilësohet si krim i urrejtjes. Prokuroria Publike gabimisht hodhi poshtë akuzat penale duke e cilësuar gabimisht krimin. Duke pasur parasysh këtë, Komiteti ngriti kallëzime penale kundër autorëve të krimit për rrezikimin e sigurisë, si një krim nga urrejtja. Gjithashtu, duke marrë parasysh që anëtarët e tjerë të familjes janë viktima të diskriminimit lidhur me aftësinë e kufizuar të fëmijës, ne parashtruan një ankesë në Komisionin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi. Për më tepër, një ankesë iu dërgua edhe Departamentit për punë të brendshme pranë MPB-së për veprime joprofesionale dhe të paligjshme ose mungesë të veprimeve të nevojshme nga nëpunësit policorë.

[Monitorimi i proceseve gjyqësore gjithashtu është një aktivitet i vazhdueshëm. Për qëllimet e këtij raporti, i nënvizojmë katër raste.](#)

1. Rasti 'Sazdo'

Komiteti i Helsinkit ka monitoruar procesin gjyqësor kundër tre personave të rinj-meshkuj që rrahën deri në vdekje të riun-pjesëtar i 'Komiti' Nikolla Sazdovski – Sazdo për shkak të intolerancës së supozuar etnike më 29 qershor 2018. Rasti përfundoi në procedurën gjyqësore të shkallës së parë dhe dy nga të pandehurit u shpallën fajtorë për vrasje dhe u dënuan me 19 vjet burg secili. Prokuroria publike dhe gjykata nuk e njohën këtë çështje si një krim të urrejtjes në asnjë fazë, duke dështuar t'i dërgojnë një mesazh të duhur publikut dhe autorëve të mundshëm. Komisioni vazhdon të monitorojë zhvillimet e çështjes para Gjykatës së Apelit.

Për të sqaruar, si viktima ashtu edhe autorët e krimit ishin 19 dhe 20 vjeç. Viktima u rrah rëndë në një stacion të frekuentuar autobusi në Shkup nga tre bashkëmoshatarë, pas së cilës ai ra në koma dhe vdiq dhjetë ditë më vonë si rezultat i lëndimeve të pësuar.⁶² Sipas treguesve të çështjes, kishte një arsye për të besuar se rrahja ishte motivuar nga intoleranca etnike midis maqedonasve dhe shqiptarëve dhe kjo është arsyeja pse çështja u regjistrua nga Komiteti i Helsinkit si një krim i urrejtjes. Në fillim, prokurori i parë e cilësoi aktin si dhunë, por pas vdekjes së viktimës, çështja u rikualifikua si një vrasje e kryer në një mënyrë brutale. Komisioni, që nga fillimi, ka monitoruar me vëmendje të veçantë procedurat gjyqësore dhe vuri në dukje, me shqetësim, se gjykata ka shkelur vazhdimisht dispozitat e Ligjit për Procedurën Penale. Që nga fillimi i seancës kryesore dëgjimore, vëzhguesit e Komitetit vunë re se Këshilli Gjyqësor, në veçanti

62 9 korrik 2018.

kryetari i Këshillit Gjyqësor, po vepronte në përputhje me Ligjin e vjetëruar të Procedurës Penale në vend të dispozitave në fuqi. Shkeljet e tilla të ashpra të ligjit procedural rrezikojnë të gjithë procesin dhe të drejtat e të akuzuarit, të cilat mund të rezultojnë me mosndëshkim të autorëve për shkak të shkeljeve gjatë procesit.

Komiteti i Helsinkit vuri në dukje se në çdo procedurë, siç ishte kjo, gjykata duhet të jetë objektive, e paanshme dhe duhet të respektojë me përpikëri dispozitat që rregullojnë procedurën në mënyrë që të garantojnë gjykimin e drejtë të të akuzuarit dhe të mbrojnë të drejtat e të dëmtuarit dhe viktimës. Vetëm një qasje e tillë mund të çojë në një proces të drejtë. Deri në fund të vitit 2018, prokuroria ishte ende në proces të dorëzimit të provave.⁶³ Më 23 prill 2019, Gjykata Penale dënoi Besir Belën dhe Skender Demirin me 19 vjet burg për vrasjen e Nikolla Sazdovski - Sazdo. I pandehuri i tretë Jeton Luzha ishte në arrati dhe i padisponueshëm për autoritetet deri në shtator të vitit 2020, kur edhe u ekstradua nga Gjermania. Sipas Gjykatës Penale, të pandehurit që vepruan bashkarisht janë fajtorë për vrasjen brutale të Nikolla Sazdovskit. Mënyra brutale e privimit nga jeta u theksua gjithashtu edhe nga Prokuroria në aktakuzë dhe të akuzuarit gjithashtu duhet të paguajnë kompensim monetar për dhimbjen shpirtërore shkaktuar anëtarëve të familjes së Nikollës.

2. Sulme ndaj Qendrës për mbështetje të komunitetit LGBTI

Një nga rastet më eklatante të mosveprimit të Prokurorisë Publike në lidhje me krimet e urrejtjes janë gjashtë sulmet ndaj Qendrës për mbështetje të komunitetit LGBTI, një degë e Komitetit të Helsinkit, sulme të kryera në periudhën midis viteve 2012 dhe 2016. OSHC-të bënë thirrje për zbardhje të shpejtë të rasteve, zbulimin e autorëve të veprës penale, dhe ndjekjen penale efektive për dhunë, duke shkaktuar rrezik të përgjithshëm dhe diskriminim racor dhe diskriminim tjetër. Deri më tani nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga prokurorët, edhe pse sulmuesit janë regjistruar nga kamerat e sigurisë. Në muajin shkurt të këtij viti, u regjistrua edhe një incident tjetër i motivuar nga orientimi seksual. Incidenti i referohej tablove të reklamave (billboard) me mesazhe për LGBTI në Manastir që u dëmtuan duke vizatuar simbole naziste. Pavarësisht mesazheve pozitive dhe mbështetjes së dhënë publikisht të Qeverisë dhe figurave politike publike, deri më sot, autoritetet gjyqësore nuk kanë zgjidhur këtë ose ndonjë prej akteve të mëparshme të krimeve të urrejtjes kundër komunitetit LGBTI.⁶⁴

3. Rasti 'Milenko Nedellkovski'

Komiteti ka ndjekur rastin kundër figurës publike Milenko Nedellkovski për nxitje të urrejtjes kombëtare dhe dhunës në lidhje me zjarret në Greqi në gusht të vitit 2018. Gjykata Themelore Penale në Shkup liroi nga përgjegjësia gazetarin Milenko Nedellkovski. Aktakuza kundër gazetarit Milenko Nedellkovski u ngrit për publikimin e një statusi në Facebook me gjuhë të urrejtjes, e cila u iniciua nga Prokuroria Publike sipas detyrës zyrtare (*ex officio*). Arsyeja për një vendim të tillë ishte pamundësia e Prokurorisë Publike për të provuar akuzat kundër Nedellkovskit, të cilat gjykata i konsideroi si prova të krimin. Gjatë 2 viteve dhe 19 seancave, dëshmitarët (inspektorët nga Ministria e Punëve të Brendshme) të thirrur nga Prokuroria Publike dhe ekspertiza e dorëzuar nga Prokuroria, nuk e vërtetuan fajësinë e Nedellkovskit. Gjatë gjithë procesit, Nedellkovski pretendoi se e gjithë kjo ishte bërë për ta heshtur atë dhe për ta privuar nga liria e tij e shprehjes, veprimit, fjalës dhe mendimit. Në të kaluarën, Nedellkovski ishte i njohur për përdorimin e tij të vazhdueshëm të gjuhës së urrejtjes dhe nxitjen e diskriminimit dhe dhunës ndaj personave dhe grupeve në bazë të seksit, racës, ngjyrës, gjinisë, grupit të marginalizuar, etnisë, gjuhës, kombësisë, origjinës sociale, fesë ose besimit, besimeve të tjera, edukimit, përkatësisë politike, statusit personal ose shoqëror, paaftësisë mendore ose fizike dhe moshës.

⁶³ Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Raport vjetor për krimet nga urrejtjes për vitin 2019.

⁶⁴ Komiteti i Helsinkit për këtë ka raportuar në: <http://shorturl.at/dBW79>.

4. Rasti 'Monstra'

Komiteti monitoroi gjykimin e rastit 'Monstra' ku u vranë 5 persona në prag të Festës së Pashkëve në vitin 2012. Alil Demiri, Afrim Ismailoviç, Agim Ismailoviç, Fejzi Aziri, Haki Aziri dhe Sami Luta u arrestuan në vitin 2012, menjëherë pasi trupat e katër të rinjve, Filip Sllavkovski, Aleksandar Naqevski, Cvetanço Acevski dhe Kire Triçkovski, të gjithë midis moshës 18-20 vjeç, u gjetën më 12 prill, para Pashkëve. Trupat u gjetën afër liqenit të Smillkovës, jo larg nga Shkupi. Ata ishin të renditur në radhë, që bënte me dije se ata ishin ekzekutuar. Trupi i 45-vjeçarit Borçe Stevkovski ishte gjetur në afërsi. Në atë kohë, lajmi i vrasjeve ngriti tensionet etnike pasi një grup maqedonasish organizuan protesta, të dhunshme në momente, duke fajësuar për vrasjet pakicën më të madhe në vend, shqiptarët. Në qershor të vitit 2014, Gjykata Penale Shkup, të gjithë të pandehurit i gjeti faktorë. Ata morrën dënimin më të rëndë të mundshëm për vepra penale të terrorizmit – burgim të përjetshëm. Sipas aktgjyimit në atë kohë, Alil Demiri dhe Afrim Ismailoviç vranë pesë maqedonasit me pistoleta automatike, përdërisa të tjerët supozohet se kanë ofruar ndihmë logjistike. Të pandehurit u deklaruan të pafajshëm, duke argumentuar se rasti ishte një “konstrukcion” politik i organizuar nga Qeveria.

Ky rast u bë edhe më i diskutueshëm kur u ngrenë dyshime të ngjashme nga partitë shqiptare në vend, si dhe nga partia më e madhe e opozitës në atë kohë, Lidhja Socialdemokrate, e cila sot është në pushtet. Me një lëvizje të papritur të ngjarjeve në tetor të vitit 2017, prokuroria i propozoi Gjykatës së Lartë të shfuqizonte dënimet e përjetshme, të cilin edhe e bëri. Rigjykimi filloi në muajin maj 2018. Të pandehurit vazhduan të deklarorin pafajësinë e tyre, kurse prokuroria parashtroi prova të reja. Deri më tani, disa dëshmitarë okularë, ekspertë të forenzikës dhe politikanë kanë dëshmuar para gjykatës. Procesi gjyqësor është në vazhdim e sipër.

4.10 Inforgrafik me pasqyrë të dhënash për 8 vitet e kaluara

Infografiku pasqyron të dhënat e krimeve të urrejtjes të mbledhura midis viteve 2013 dhe 2020 si një përmbyllje e bashkëpunimit midis OSBE-së dhe Komitetit të Helsinkit. Ai u botua në maqedonisht, shqip dhe anglisht në Ditën Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut më 10 dhjetor dhe pati një pritshmëri të madhe nga publiku i gjerë dhe nga disa media që raportuan për këtë aktivitet. Postimet në mediat sociale arritën te 44.405 persona dhe ato u shpërndanë nga mbi 40 media. Deri më 1 janar 2021, Komiteti i Helsinkit ka regjistruar 773 krime të urrejtjes dhe të gjitha të dhënat mund të gjenden në foton e mëposhtme.

TË DHËNA PËR KRIMET NGA URREJTJA


SHKURT 2013 – DHJETOR 2020

Numri i përgjithshëm i incidenteve

773




LLOJE MË TË SHPESHTA TË INCIDENTEVE



Më së paku 967 viktima 2 538 kryerës

KARAKTERISTIKA TË VIKTIVAVE



INCIDENTE SIPAS LOKACIONIT

559 – Shkup
44 – Kumanovë
29 – Tetovë
24 – Manastir
19 – Prilep
13 – Gostivar
12 – Gjevgjeli

Shtip – 4
Strumicë – 4
Koçan – 3
Demir Kapi – 3
Vinicë – 3
Dellçevë – 2
Sveti Nikollë – 2



9 – Strugë
9 – Ohër
7 – Kërçovë
7 – Negotinë
7 – Veles
6 – Kavadarci

Makedonska Kamenicë – 2
Demir Hisar – 1
Resnjë – 1
Krushevë – 1
Kriva Pallankë – 1
I panjohur – 1

Përgjigje institucionale për rastet



Kryerës të zbuluar.....326
Helime.....198
Nuk ka informata.....196
Të paparaqitur sipas zgjedhjes së viktimit.....53



Zgjidhje ligjore

Akuza penale.....131
Akuza për kundërvajtje.....75
Të paregjistruara.....56

Një vepër nga urrejtja, shprehimisht e parashikuar në dispozitat e këtij Kodi, konsiderohet një vepër penale kundër një personi fizik ose juridik dhe personave të ndërlidhur me ta ose pasurisë që është kryer plotësisht ose pjesërisht për shkak të një karakteristike reale ose të supozuar (të imagjinuar, të konceptuar) ose lidhjes së personit që i referohet racës, ngjyrës së lëkurës, kombësisë, përkatësisë etnike, fesë ose besimit, aftësive të kufizuara mendore ose fizike, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual dhe besimit politik.

Përbajtja e këtij botimi nuk i reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet ose qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup.

osbe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup



zlostorstvaodomraza.mk
helikom@mhc.org.mk
++389 (0)2 3119 073

4.11 Aksion i përbashkët me Qytetin e Shkupit për heqjen e mbishkrimeve që përmbajnë gjuhë të urrejtjes

Ky aksion ka synuar të mbulonte mbishkrimet e urrejtjes në të gjithë qytetin. U dakordua një koordinim me kabinetin e kryetarit të Qytetit të Shkupit dhe vepruam në disa vendndodhje nëpër tërë qytetin. Rezultatet e monitorimit të gjuhës së urrejtjes në Republikën e Maqedonisë së Veriut të kryera nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, tregojnë një rritje të dyfishtë të raportimeve të regjistruara në vitin 2020, krahasuar me vitin 2019. Fyerjet gjenden më së shumti në rrjetet sociale, në hapësirat publike në formën e shenjave/simboleve dhe në formën e mbishkrimeve në ndërtesa dhe tabela reklamash. Duke pasur këtë parasysh, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut kërkoi Leje nga Komuna e Qytetit të Shkupit për heqjen, respektivisht mbulimin e teksteve dhe mbishkrimeve të shkruara që përmbajnë gjuhë urrejtjeje në ndërtesa dhe sipërfaqe të territorit të Qytetit të Shkupit. Ky aksion u krye gjatë muajve nëntor dhe dhjetor, në disa vende në të gjithë qytetin ku u regjistruan shkrime dhe mbishkrime/grafite që përmbajnë gjuhë urrejtjeje. Në këtë drejtim, ne ritheksojmë se toleranca është thelbësore për ruajtjen e paqes dhe përparimin ekonomik dhe shoqëror të të gjithë njerëzve, dhe kjo vlen veçanërisht për shoqëritë si e jona që janë multietnike dhe multikulturore.


Ne arritëm të mbulonim tre lagje në të gjithë qytetin, në Bit Pazar, Aerodrom dhe Avtokomandë dhe pati një pritje të shkëlqyeshme nga publiku i gjerë, dhe nga disa media që raportuan për këtë aktivitet. Të gjitha të dhënat janë në dispozicion në postimet e mediave sociale. Artistët e grafitëve/mbishkrimeve janë Kamelija Kalamernikova dhe Pande Eftimov.



Një pjesë e urës së Bit Pazarit para aksionit



Një pjesë e urës së Bit Pazarit pas aksionit



Një pjesë e urës së Bit Pazarit pas aksionit

Pritja e popullatës lokale ishte jashtëzakonisht pozitive, njerëzit na mbështetën dhe ofruan ndihmë për artistët e grafitëve. Sidoqoftë, koordinatori i projektit mori disa mesazhe urrejtjeje dhe një kërcënim në internet për të mos ndërhyrë në 'artin lokal'.



Pjesë në Aerodrom para aksionit



Pjesë në Aerodrom pas aksionit

Ngjashëm me aksionin e parë, pritja e popullatës lokale ishte jashtëzakonisht pozitive, njerëzit na mbështetën dhe ofruan ndihmë për artistët e grafitëve. Sidoqoftë, koordinatori i projektit mori disa mesazhe urrejtjeje në internet dhe një kërcënim për mirëqenien fizike nga një profil i quajtur 'Familija Aerodrom' që të jetë i kujdesshëm kur kalon nëpër komunë, në rast se vendos të vazhdojë me aksionin.



Pjesë në Autokomandë para aksionit



Pjesë në Autokomandë pas aksionit

Ngjashëm me dy aksionet e para, pritja e popullatës lokale ishte jashtëzakonisht pozitive, njerëzit na mbështetën dhe ofruan ndihmë për artistët e grafitëve. Sidoqoftë, koordinatori i projektit mori disa mesazhe urrejtjeje në internet.

5. PËRFUNDIME

Maqedonia e Veriut ende ka vështirësi në parandalimin dhe mbledhjen e të dhënave për krimet e urrejtjes. Problemi është edhe më i madh kur pranohet realiteti se kjo çështje rrallë ose pothuajse kurrë nuk është diskutuar në diskursin publik dhe është e pasigurt nëse mund të presim ndonjë ndryshim në gjetjet e këtij raporti në një të ardhme të afërt. Nuk ka gjasa që së shpejti do të kemi në dispozicion një plan gjithëpërfshirës dhe të krahasueshëm se si t'i qasemi kësaj problematike. Krimet e urrejtjes zakonisht nuk raportohen, madje edhe kur përfundojnë si ankesa zyrtare, ato nuk hetohen si duhet nga autoritetet sepse nuk janë të trajnuar për të identifikuar dhe trajtuar krimet e urrejtjes. E gjithë kjo ndikon më shumë te të rinjtë, veçanërisht ata që rastësisht janë pjesë e një grupi tjetër pakicash siç është komuniteti LGBTI, të cilët kanë mbetur të vetmuar pa ndonjë mbrojtje sistematike të karakteristikave të tyre identitare..

Ky raport ka treguar se krimet e urrejtjes zakonisht ndodhin në publik dhe se një numër i madh incidentesh ndodhën në autobusë, pranë stacioneve të autobusëve, rreth shkollave dhe afër stacioneve të trenit. Shumë krime të urrejtjes kryhen për hakmarrje ose si pasojë e një incidenti të mëparshëm midis të rinjve maqedonas etnikë dhe shqiptarë etnikë. Duke pasur parasysh se është bërë shumë pak përpjekje në funksion të masave parandaluese, edukimit për të drejtat e njeriut dhe ngritjes së ndërgjegjësimit publik, pritjet që kjo tendencë negative të vazhdojnë të shfaqet, ndërsa institucionet e shpërfillin problematikën. Përfundimet e këtij raporti mund të përmbliidhen në pikat në vijim:

- Tendenca e rritjes së numrit të incidenteve të krimeve të urrejtjes të regjistruara në vitin 2018, e që vazhdoi edhe në vitin 2019, këtë vit është zvogëluar; Megjithatë, për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme në vend gjatë vitit 2020, të shkaktuara nga KOVID-19, është akoma shumë herët të arrihet në një përfundim sa i përket këtij trendi.
- Kishte një rënie të numrit të incidenteve që ndodhin në bazë të përkatësisë etnike dhe numri i incidenteve të tilla ka rënë nga 86% në 73,1% i të gjitha incidenteve të regjistruara. Sidoqoftë, duke marrë parasysh kufizimet e vendosura për shkak të KOVID-19 dhe qasjen drastikisht të ndryshme ndaj fushatave politike, nuk është e mundur të dallohet në këtë pikë nëse atmosfera e përgjithshme në vend në këtë aspekt është përmirësuar. Pothuajse të gjitha këto incidente kanë ndodhur midis maqedonasve dhe shqiptarëve, dhe ato vazhdojnë të jenë shkak i një shqetësimi të madh duke pasur parasysh se numri më i madh i viktimave dhe autorëve të atyre incidenteve janë të mitur/të rinj;
- Gjuha e urrejtjes e përdorur nga politikanët gjatë debateve dhe fushatave publike, shpesh rezultojnë në krime të urrejtjes të kryera nga mbështetësit e tyre. Gjuha e urrejtjes përdoret gjerësisht edhe në seksionet e komenteve të mediave elektronike që gjenerojnë lajme politike;
- Ka pasur një rënie të lehtë të numrit të incidenteve të motivuara nga përkatësia politike, por tendenca nga dy vitet e mëparshme në lidhje me incidentet e njëanshme politike mbetet e njëjtë edhe këtë vit;
- Përveç faktit që në vitet e mëparshme Qeveria ka ndërmarrë hapat e saj të parë drejt rritjes së mbrojtjes së të drejtave të komunitetit LGBTI dhe faktit që u zgjodh një prokuror i ri publik, rastet e krimit të urrejtjes kundër komunitetit LGBTI që u regjistruan në periudhën 2013- 2015 janë ende të pazgjidhura nga zyra e prokurorit.

- Është ende e paqartë nëse institucionet janë të vetëdijshme për dallimin midis krimit të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes;
- Disa nga krimet e urrejtjes janë kryer si hakmarrje për incidentet e mëparshme midis të rinjve maqedonas dhe shqiptarë dhe kundër komunitetit rom;
- Krimet me motive të njëanshme ende nuk janë regjistruar ose hetuar si duhet nga policia dhe zyrat e prokurorisë;
- Janë bërë shumë pak përpjekje për të vendosur masa parandalimi, përfshirë edukimin për të drejtat e njeriut dhe ngritjen e ndërgjegjësimit publik, veçanërisht në mesin e nxënësve të shkollave të mesme dhe të rinjve, duke pasur parasysh se shumica e viktimave dhe një numër i konsiderueshëm i autorëve të krimit janë të mitur ose persona të rinj; dhe
- Duke pasur parasysh faktin se fenomeni i krimit të urrejtjes nuk trajtohet si çështje e ndarë, shteti nuk ofron mbrojtje dhe mbështetje të veçantë për viktimat.

6. REKOMANDIME

Angazhimi publik forcon besimin tek institucionet. Prokurorët nuk duhet të presin për një rast të dukshëm dhe shumë publik të krimit të urrejtjes për të filluar krijimin e kontakteve me komunitetin. Komunikimi dhe konsultimi i rregullt me grupet e komunitetit mund të japë rezultate pozitive duke përmirësuar gatishmërinë e viktimave dhe dëshmitarëve për të bashkëpunuar me institucionet e zbatimit të ligjit dhe për të kuptuar më mirë për atë që po ndodh në komunitet. Këto kontakte mund të sigurojnë gjithashtu që përballë tensioneve në rritje midis bashkësive, policia mund të qetësojë më mirë situatën dhe të dijë kur të rrisë praninë e policisë për të adresuar shqetësimet e komunitetit. Rekomandimet që kemi në këtë drejtim janë si më poshtë:

- Hetim dhe ndjekje të shpejtë dhe efektive penale të krimeve të urrejtjes duke siguruar që motivet e njëanshme të merren në konsideratë gjatë procedurave penale ë sigurohet hetim i shpejtë dhe efektiv dhe prokurim i krimeve të urrejtjes duke siguruar se motivet e paragjykitimit janë marrë në konsideratë gjatë gjithë procesit penal;
- Të merren masat e nevojshme për të lehtësuar raportimin e krimeve të urrejtjes nga viktimat, përfshirë masat për të krijuar besim në polici dhe institucionet e tjera shtetërore;
- Të mblidhen dhe botohen të dhëna gjithëpërfshirëse dhe të krahasueshme për krimet e urrejtjes, për aq sa është e mundur, si dhe numrin e këtyre incidenteve të raportuara nga publiku dhe të regjistruara nga autoritetet policore; numri i aktgjykimeve; motivet e njëanshme prapa këtyre veprave penale dhe dënimeve të shqiptuara;
- Të ofrohet mbështetje dhe mbrojtje për viktimat e krimeve të urrejtjes;
- Të organizohen trajnime për institucionet përkatëse që vijnë në kontakt me viktimat e krimit të urrejtjes, në mënyrë që ata t'i ndihmojnë në mënyrë efektive dhe
- Të ketë më shumë masa parandalimi, përfshirë kthimin e konceptit të mbajturit mend (memorizim) në edukimin për të drejtat e njeriut, programet mësimore nga historia dhe trajnimet përkatëse, marrjen e hapave për të edukuar publikun, veçanërisht të miturit dhe të rinjtë për vlerat e diversitetit kulturor dhe përfshirjen (inkluzionin), dhe përpjekje nga të gjithë sektorët e shoqërisë për të luajtur një rol më të madh në luftimin e intolerancës.

ANEKSI – INCIDENTET E REGJISTRUARA NGA URREJTJA PËR VITIN 2020

1. Dhunë në autobusin nr. 57

Çfarë ka ndodhur: Më 01.01.2020 në ora 23.50 në Sektorin e Punëve të Brendshme (SPB) në Shkup, G.T. (42) nga Shkupi denoncoi se rreth orës 22.50 në autobusin e Ndërmarrjes Qarkulluese Publike (NQP) me nr. 57, tre persona fizikisht e kanë sulmuar djalin e tij dhe ia kanë marrë paratë. Janë ndërmarrë masa për zbardhjen e rastit.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 1 janar 2020, në ora 22.50, në Shkup (linja e autobusit nr. 57).

Burimi i informacionit: buletini ditor i Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB).

Viktima të përfshira: një (1) viktimë e mitur.

Lloji i veprës penale: Grabitje (Neni 237 i Kodit Penal).

Autorë: tre (3) autorë të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Prejardhja etnike* – viktima dhe sulmuesi u përkisnin bashkësive të ndryshme etnike.
2. Modeli i incidenteve të mëparshme – sulme të mëparshme ndaj njerëzve në linjën e autobusit nr. 57.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Nuk ka konfirmim mbi indikatorët nga MPB-ja për këtë incident.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji e sjellin në pikëpyetje gjendjen e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën me grupet e ndryshme etnike në shoqëri.

2. Sulm fizik ndaj dy të miturve në Shkup

Çfarë ka ndodhur: Më 03.01.2020 në ora 01.00, në SPB në Shkup, B.B. (49) dhe M.A. (41), të dy nga Shkupi, kanë denoncuar se më 02.01.2020 rreth orës 22.40 në rrugën “Pariska komuna”, fëmijët e tyre ishin sulmuar nga dy persona. Janë ndërmarrë masa për zbardhjen e rastit.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 02.01.2020 rreth orës 22.40, në rrugën “Pariska komuna” në Shkup.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Dy (2) viktima të mitur.

Lloji i veprës penale: Dhunë (Neni 386 nga Kodi Penal).

Autori: Dy (2) autorë të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Prejardhja etnike* – viktima dhe sulmuesi u përkisnin bashkësive të ndryshme etnike.
2. *Vendndodhja* – incidente të mëparshme në Vendndodhjen e njejtë.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Nuk ka konfirmim për indikatorët nga MPB për këtë incident.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji e vënë në pyetje gjendjen e sigurisë së përgjithshme në vend dhe bashkëjetesën me grupet e ndryshme etnike në shoqëri.

3. Incident i urrejtjes në parkingun e bulevarit “Goce Delçev”

Çfarë ka ndodhur: Më 13.01.2020 në ora 16.30 në SPB në Shkup, E.S. (32) nga Kosova ka denoncuar se rreth orës 14.30 në parkingun në bul. “Goce Delçev” dy persona e kanë sulmuar fizikisht dhe prej automjetit të saj “Shkoda Superb”, me targa kombëtare kosovare, i marrën një laptop. Janë ndërmarrë masa për zbardhjen e rastit.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 13.01.2020, 14:30, bul. Goce Delçev, Shkup.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Një (1) viktimë.

Lloji i veprës penale: Grabitje (Neni 237 i Kodit Penal).

Autori: Dy (2) autorë të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Prejardhja etnike* – viktimja dhe sulmuesi u përkisnin bashkësive të ndryshme etnike.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Nuk ka konfirmim për indikatorët nga MPB për këtë incident.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji e vënë në pyetje gjendjen e sigurisë së përgjithshme në vend dhe bashkëjetesën me grupet e ndryshme etnike në shoqëri.

4. Krim kibernetik nga urrejtja

Çfarë ka ndodhur: Më 17.01.2020, Zyra e jashtme për çështje kriminalistike në Koçanë ngriti padi penale kundër S.J. (61) prej fsh. Çeshinovë dhe D.A. (36) prej fsh. Obleshevë, për shkak të dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale “Shpërndarja e materialit racist dhe ksenofobik përmes sistemeve kompjuterike”. Të pandehurit, gjatë vitit 2019 nga llogaria e S.J. në “Facebook”, publikisht kanë shpërndarë fotografi dhe statuse, të cilat kanë promovuar ose nxitur urrejtje dhe dhunë.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: Të panjohur.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Të pacaktuara.

Lloji i veprës penale: Shpërndarje e materialit racist dhe ksenofobik përmes sistemeve kompjuterike (Neni 394-g paragrafi 1 i Kodit Penal).

Autori: Dy (2) autorë të identifikuar.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – nxitja dhe përhapja e urrejtjes etnike dhe nxitja e dhunës përmes rrjeteve sociale është një mënyrë gjithnjë e më e zakonshme për të kryer krime të urrejtjes.

Statusi i rastit: është ngritur padi penale.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Autorë të identifikuar, padi penale e ngritur.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji e vënë në pyetje gjendjen e sigurisë së përgjithshme në vend dhe bashkëjetesën me grupet e ndryshme etnike në shoqëri.

5. Privim i jashtëligjshëm nga liria i një migranti nga Maroku

Çfarë ka ndodhur: Më 17.01.2020 rreth orës 11.00 në stacionin policor në Sopot, M.M (25) nga Palestina dhe H.S. (26) nga Maroku, migrantë të strehuar në Qendrën tranzitore Tabanovc, kanë denoncuar se dy ditët e fundit A.K. (28) nga Maroku ishte mbajtur në shtëpi në fsh. Vaksincë nga disa persona nga Pakistani dhe nga fsh. Vaksincë, me qëllim për t'i zhvatur para. Janë ndërmarrë masa për zbardhjen e rastit.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 16-17.01.2020, fsh. Vaksincë.

Burimi i informacionit: Buletini ditore i MPB-së.

Viktima të përfshira: Një (1) viktimë.

Lloji i veprës penale: Privim i jashtëligjshëm nga liria (Neni 140 paragrafi 2 i Kodit Penal).

Autori: Më shumë autorë të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident motivi i njëanshëm është statusi i migrantit, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Prejardhja etnike* – viktimë dhe sulmuesi u përkisnin bashkësive të ndryshme etnike.
2. *Vendndodhja* – fsh. Vaksincë është vend ku kalon ruta joregulare përmjet së cilës lëvizin migrantët dhe ku shpeshherë ndodhin incidente për shkak të statusit të tyre si migrant.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Nuk ka konfirmim për indikatorët nga MPB për këtë incident.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji e sjellin në pikëpyetje gjendjen e përgjithshme të sigurisë dhe stabilitetin e vendit.

6. Dhunë mes bashkëmoshatarëve

Çfarë ka ndodhur: Më 24.01.2020 në ora 15,00 në stacionin policor Gazi Babë L.K. (51) nga Shkupi ka denoncuar se të njëjtën ditë rreth orës 12,50 në rrugën “Sava Mihajllor” ka qenë i sulmuar fizikisht djali i saj 16-vjeçar nga një i mitur tjetër. Po punohet për zbardhjen e rastit.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 24.01.2020 në ora 12.50, Rr. “Sava Mihajllor”, Shkup.

Burimi i informacionit: Buletini ditore i MPB-së.

Viktima të përfshira: Një (1) viktimë e mitur.

Lloji i veprës penale: Dhunë (Neni 386 i Kodit Penal).

Autori: Një (1) autor i mitur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Prejardhja etnike* – viktimë dhe sulmuesi u përkisnin bashkësive të ndryshme etnike.
2. *Vendndodhja* – ky është një vend ku lëvizin njerëz me prejardhje të ndryshme etnike.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Nuk ka konfirmim për indikatorët nga MPB për këtë incident.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji e vënë në pyetje gjendjen e sigurisë së përgjithshme në vend dhe bashkëjetesën me grupet e ndryshme etnike në shoqëri.

7. Dhunë mes bashkëmoshatarëve në institucion publik për shkak të mosdurimit të ndërsjellë

Çfarë ka ndodhur: Më 27.01.2020 në ora 15.00 në SPB Shkup është denoncuar se rreth orës 14.45, në oborrin e institucionit publik në rr. “Pero Nakov”, XH.R. (18) nga Shkupi, për shkak të mosdurimit të ndërsjellë, ka qenë e sulmuar fizikisht nga A.SH. (19) nga Shkupi. Janë ndërmarrë masa për zbardhjen e rastit.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 27.01.2020, rreth orës 14.45, institucioni publik në Rr. “Pero Nakov”, Shkup.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Një (1) viktimë.

Lloji i veprës penale: Dhunë (Neni 386 i Kodit Penal).

Autori: Një (1) autor.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Prejardhja etnike* – viktima dhe sulmuesi u përkisnin bashkësive të ndryshme etnike.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Nuk ka konfirmim për indikatorët nga MPB për këtë incident.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji e vënë në pyetje gjendjen e sigurisë së përgjithshme në vend dhe bashkëjetesën me grupet e ndryshme etnike në shoqëri.

8. Katër të mitur sulmuan një të mitur tjetër në qendrën e Shkupit

Çfarë ka ndodhur: Më 27.01.2020 në ora 18.00 në SPB Shkup, M.S. (56) nga Shkupi ka paraqitur se në ora 16.00 në udhëkryqin ndërmjet rr. “Makedonija” dhe rr. “Lluj Paster” djali i tij i mitur ka qenë i sulmuar fizikisht nga katër të mitur. Janë ndërmarrë masa për zbardhjen e rastit.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 27.01.2020, 16:00, udhëkryqi ndërmjet rr. “Makedonija” dhe rr. “Lluj Paster”, Shkup.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Një (1) viktimë e mitur.

Lloji i veprës penale: Dhunë (Neni 386 i Kodit Penal).

Autori: Një autor i identifikuar (I.J. 49).

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Prejardhja etnike* – viktima dhe sulmuesi u përkisnin bashkësive të ndryshme etnike.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Nuk ka konfirmim për indikatorët nga MPB për këtë incident.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji e sjellin në pikëpyetje gjendjen e përgjithshme të sigurisë dhe stabilitetin e vendit.

9. Përleshje fizike midis dy grupeve para shkollës në Bul. “Treta Makedonska Brigada”

Çfarë ka ndodhur: Më 03.02.2020 në ora 17.00 në SPB Shkup është denoncuar se para shkollës në Bul. “Treta Makedonska Brigada” ka ardhur deri te prishja e rendit dhe qetësisë publike me një përleshje fizike midis dy grupeve, përfshirë të mitur. Si rezultat, U.D. (18) nga Shkupi pësoi lëndim nga therja, pas së cilit u transferua në Kompleksin e klinikave “Nëna Terezë” për t’iu ofruar ndihmë mjekësore. Janë ndërmarrë masa për zbardhjen e rastit.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 03.02.2020, në ora 17.00, shkolla në Bul. “Treta Makedonska Brigada”, Shkup.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Një (1) viktimë e mitur.

Lloji i veprës penale: Dhunë (Neni 386 i Kodit Penal).

Autori: Më shumë autorë të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Prejardhja etnike* – viktimë dhe sulmuesi u përkisnin bashkësive të ndryshme etnike.
2. *Vendndodhja* – incidente të mëparshme në këtë vend.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Nuk ka konfirmim për indikatorët nga MPB për këtë incident.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji e vënë në pyetje gjendjen e sigurisë së përgjithshme në vend dhe bashkëjetesën me grupet e ndryshme etnike në shoqëri.

10. Përleshje fizike midis studentëve në shtëpinë e studentëve në Shkup

Çfarë ka ndodhur: Më 04.02.2020 në ora 23.30 në SPB Shkup, P.S. (24) nga fsh. Miravci i Gjevgjelisë, ka denoncuar se rreth orës 23.00 në shtëpinë e studentëve në bul. “Aleksandar Makedonski”, ai dhe M.M. (22) prej R. së Serbisë kanë qenë të sulmuar fizikisht nga G.B. (21) nga R. e Shqipërisë, të gjithë student të strehuar në shtëpinë e studentëve. Është hartuar procesverbal për kundërvajtje të kryer në bazë të nenit 12 të Ligjit për kundërvajtje kundër rendit dhe qetësisë publike.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 04.02 i vitit 2020 në ora 23:00, shtëpia e studentëve në bul. “Aleksandar Makedonski”, Shkup.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Dy (2) viktimë.

Lloji i veprës penale: Dhunë (Neni 386 i Kodit Penal).

Autori: Një (1) autor i identifikuar.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Prejardhja etnike* – viktimë dhe sulmuesi u përkisnin bashkësive të ndryshme etnike.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Është konstatuar kundërvajtje sipas nenit 12 të Ligjit për kundërvajtje kundër rendit public dhe paqes.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji e vënë në pyetje gjendjen e sigurisë së përgjithshme në vend dhe bashkëjetesën me grupet e ndryshme etnike në shoqëri.

11. Simbole naziste të vizatuara në tablo reklamash (billboard)

Çfarë ka ndodhur: Më 03.02.2020, si pjesë e një aksioni artistik, në Manastir u instaluan tri tablo reklamash (billboard), në tre vende të ndryshme. Në tabllotë ishte ilustruar një bar (ilaç) fiktiv “Homofobiol”, si pjesë e një intervenimi artistik të autorëve në hapësirë publike. Po të njëjtën mbrëmje, dy tablo në qytet ishin spërkatur me ngjyrë të bardhë, kurse mbrëmjen e ardhshme, më 04.02.2020 ishin vizatuar simbole naziste me ngjyrë të zezë. Më 05.02.2020, tabllotë ishin spërkatur krejtsisht me ngjyrë të zezë. Më 14.02.2020, Qendra për mbështetjen e komunitet LGBTI rastin e denoncoi në MPB- SPB Manastir.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 03.02.2020, koha e papërcaktuar, Manastir.

Burimi i informacionit: Denoncim në Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.

Viktima të përfshira: Të papërcaktuara.

Lloji i veprës penale: Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose intolerancës në bazë të diskriminimit etnik, racor, fetar ose diskriminimit tjetër etj. (Neni 319 i Kodit Penal).

Autori: Autorë të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Orientimi seksual* – Prania e komunitetit LGBTI në hapësira publike është në shënjestër të dhunës, përpjekjeve për fshirje dhe vandalizmit.
2. *Model i incidenteve të mëparshme* – prani e gjuhës së urrejtjes dhe sulme të mëparshme ndaj personave të komunitetit LGBTI.

Statusi i rastit: Padi e parashtruar në SPB Manastir.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Nuk ka konfirmim për indikatorët nga MPB për këtë incident.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji e sjellin në pikëpyetje gjendjen e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën me grupet e ndryshme në shoqëri.

12. Sulm në autobus ndaj një studenti për shkak të përkatësisë së tij etnike

Çfarë ka ndodhur: Më 09.02.2020, pas një keqkuptimi të mëparshëm me një bashkëudhëtar tjetër në autobusin nr. 45, S.U. u sulmua nga ana e dy kontrollorëve të NQP-së. Njëri kontrollor u çua dhe prej gjithë autobusit, i kërkoi biletë S.U.-së, duke e veçuar atë. Derisa S.U. po përpiqej të denonconte rastin në polici në numrin 192 dhe bisedonte me policin, vijuan një mori kërcënimesh nga ana e kontrollorëve se do ta godasin. I bërtitnin dhe sillleshin dhunshëm. Pastaj e kapën për dore dhe dhunshëm e hudhën jashtë, ku dhe i ra celulari. Gjatë gjithë kësaj kohe personi fliste në telefon me nëpunësin policor nga 192. Pasi që e zbritën në stacion, gjithashtu dhunshëm ia morën biletën. E kontrolluan dhe u vërtetuan se kishte biletë vjetore dhe pastaj biletën ia hudhën në tokë. Njëri prej kontrollorëve ndezi një cigare dhe iu kërcënua se do t’ia shuajë në ballë. Para se të largoheshin, e kishin kërcënuar me fjalët se nuk e din me cilin ka punë.

Më 25.02.2020, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ngriti kallëzim penal kundër N.N., persona zyrtarë në NQP, të punësuar si kontrollorë, për kryerjen e veprës penale “Diskriminim racor dhe diskriminim tjetër” nga Neni 417 i Kodit Penal.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 09.02.2020, koha saktësisht e papërcaktuar, në autobusin nr. 45, Shkup.

Burimi i informacionit: Denoncim në Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.

Viktima të përfshira: Një (1) viktimë.

Lloji i veprës penale: “Diskriminim racor dhe diskriminim tjetër” (Neni 417, Kodi Penal i RMV-së).

Autori: Dy (2) autorë të paignifikuar.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Prejardhja etnike* – viktimë dhe sulmuesi u përkisnin bashkësive të ndryshme etnike.
2. *Vendndodhja* – sulme të mëparshme të personave në autobusë.

Statusi i rastit: Është ngritur kallëzim penal kundër N.N, persona zyrtarë në NQP, të punësuar si kontrollorë për kryerjen e veprës penale “Diskriminim racor dhe diskriminim tjetër” nga Neni 417 i Kodit Penal.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Nuk ka konfirmim për indikatorët nga MPB për këtë incident.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji e vënë në pyetje gjendjen e sigurisë së përgjithshme në vend dhe bashkëjetesën me grupet e ndryshme etnike në shoqëri.

13. Djalë i ri i therrur me objekt të mprehtë në stacion të autobusave në fsh. Bojanë

Çfarë ka ndodhur: Më 10.02.2020 në ora 15.50 në SPB Shkup, nga Spitali i Përgjithshëm i Qytetit “8 Shtatori” ishte denoncuar se tek ata është pranuar një person me plagë therrjeje nga një objekt i mprehtë. Nëpunësit policorë dolën në vendin e ngjarjes dhe është konstatuar se bëhet fjalë për Sh.M. (18) prej fsh. Çajlanë të Shkupit. Sipas denoncimit, rreth orës 15.00 në fsh. Bojanë, në stacionin e autobusit në autobus hyri J.N. nga fsh. Bojanë dhe me objekt të mprehtë i shkaktoj plagë nga therrja në pjesën e sipërme të gjunjit të majtë. Janë ndërmarrë masa për zbardhjen e rastit.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 10.02.2020, ora 15.00, stacioni i autobusëve në fsh. Bojanë.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Një (1) viktimë.

Lloji i veprës penale: Dhunë (Neni 243 i Kodit Penal).

Autori: Një autor i identifikuar.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Prejardhja etnike* – viktimë dhe sulmuesi u përkisnin bashkësive të ndryshme etnike.
2. *Model për incidente të mëparshme* – këtij incidenti i paraprijnë incidente.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Janë ndërmarrë masa për zbardhjen e rastit.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji e sjellin në pyetje gjendjen e përgjithshme dhe të sigurisë në vend.

14. Dhunë ndaj fëmijëve romë në autobusin nr. 5 të NQP-së

Çfarë ka ndodhur: Më 12.02.2020, rreth orës 21, në autobusin nr. 5 të NQP-së, një person i panjohur, i revoltuar nga zhurma në autobus, është nisur drejt fëmijëve të përkatsisë etnike romë të cilët bisedonin me ton të lartë, që të ndalojnë zhurmën. Disa prej fëmijëve ndaluan zhurmën, por i denoncuarit vazhdoi t'i ofendojë dhe poshtësojë fëmijët në bazë të përkatsisë etnike dhe ngjyrës së lëkurës duke iu thënë: “Na

fëlliqni shtetin, prej juve nuk ka shpëtim”. Pastaj, njëri prej fëmijëve i cili më parë këndonte dhe ishte i veshur me xhakëtë të kuqe që i sulmuar fizikisht nga ana e autorit me goditje në sy dhe disa goditje në kokë. I denoncuari përveç se e ka sulmuar fizikisht, ai, ia kishte cenuar edhe sigurinë duke e kërcënuar nga jeta dhe trupi dhe duke e frikësuar se do ta dërgonte në një vend të panjohur. Gjithashtu, fëmijët nga ana e autorit qenë të detyruar t’i pastrojnë mbeturinat në autobus, kurse kur autobusi iu afrua stacionit tek Qendra Tregtare “Biser”, autori e kapi fëmijën që e kishte maltretuar fizikisht dhe i kishte thënë që duhet të zbresë me të në atë stacion. Autori e nxori dhunshëm fëmijën jashtë autobusit, duke e tërhequr përtokë dhe ia përplasi kokën në bankomatit e “NLB” Bankës e cila gjendet afër stacionit të autobusëve. Në atë moment, disa djem të panjohur vrapuan kah autori, pas së cilës ai iku nga vendngjarja.

Çfarë ka ndodhur: Më 24.09.2020 në rrjetet sociale ishte publikuar një video, ku pastër shihet se si në Manastir, disa nëpunës policorë rrahin disa persona, pjesëtarë të komunitetit rom. Ngjarja ka ndodhur më 22 shtator 2020, kur tre romë me automjet bënë aksident rrugor dhe goditën një mur betoni. Në afërsi të aksidentit ndodhej një policia e trafikut, të cilët pa ndonjë arsye i nxorën njerëzit nga makina dhe filluan t'i rrahin brutalisht, pa pyetur nëse kishin nevojë për ndihmë mjekësore. Ata u mbajtën në stacionin e policisë deri në orën 5:00 të mëngjesit, të fyer dhe të ngacmuar me shprehje të ndryshme nënçmuese në lidhje me identitetin e tyre etnik, gjuhën dhe ngjyrën e lëkurës. Personat donin të raportonin rastin në Departamentin e kontrollit të brendshëm, hetimeve kriminale dhe standardeve profesionale në Ministrinë e Punëve të Brendshme, por u refuzuan.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 22.09.2020, në Manastir.

Burimi i informacionit: Rrjete sociale, medime elektronike, gazeta dhe televizione.

Viktima të përfshira: 5 (pesë) viktima, të gjithë burra të rritur.

Lloji i veprës penale: Maltretim gjatë kryerjes së detyrës (Neni 143 i Kodit penal).

Autori: dy (2) autorë, nëpunës policorë të rritur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Motivi i njëanshëm në këtë incident është ngjyra e lëkurës, origjina e supozuar etnike dhe gjuha, dhe indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Gjuha e folur* – viktima dhe sulmuesi flisnin gjuhë të ndryshme;
2. *Ngjyra e lëkurës* – viktima kishte ngjyrë të ndryshme të lëkurës nga sulmuesi për shkak të cilës edhe u sulmuan;
3. *Prejardhja etnike* – viktima dhe sulmuesi u përkisnin bashkësive të ndryshme etnike;
4. *Vendndodhja* – Manastiri është një komunë e disa bashkësive etnike dhe ky lloji i incidenteve është regjistruar edhe më parë, veçanërisht ku viktimat janë anëtarë të komunitetit rom.

Statusi i rastit: Pas hetimit, më 25 shtator 2020, Departamenti i kontrollit të brendshëm ngriti kallëzim penal kundër nëpunësit policor G. P. nën dyshimin për kryerjen e veprës penale "Maltretim gjatë kryerjes së detyrës".

Përgjigja e autoriteteve lokale: Nuk ka konfirmim për indikatorët e MPB-së për këtë incident.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike dhe gjuhësore në shoqëri, dhe veçanërisht e zvoglojnë besimin e qytetarëve mbi policinë.

82. Sulm fizik për shkak të përkatësisë së ndryshme etnike

Çfarë ka ndodhur: Më 27.09.2020 në SP Qendër, një 21-vjeçar ka paraqitur në polici se një mashkull 21-vjeçar e ka sulmuar fizikisht pa ndonjë arsye.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 27.09.2020 në komunën Qendër, Shkup.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Një viktimë, mashkull 21-vjeçar.

Lloji i veprës penale: Dhunë (Neni 386 i Kodit penal).

Autori: Një autor, mashkull 21-vjeçar.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Motivi i njëanshëm në këtë incident është origjina e supozuar etnike sepse viktima fliste një gjuhë tjetër nga sulmuesi dhe indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Gjuha e folur* – viktima dhe sulmuesi flisnin gjuhë të ndryshme;
2. *Prejardhja etnike* – viktima dhe sulmuesi u përkisnin bashkësive të ndryshme etnike;

Statusi i rastit: SP Qendër ka përpiluar një procesverbal kundërvajtje të konstatuar sipas Nenit 12 të Ligjit kundër një personi.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Autoritetet besojnë se me akuzën për kundërvajtje, sulmi fizik është zbardhur .

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike dhe gjuhësore në shoqëri.

83. Përleshje mes të miturve në afërsi të Parkut të qytetit të Shkupit

Çfarë ka ndodhur: Më 02.10 rreth orës 20.50 në SPB Shkup, është paraqitur se në rr. 1732, 14 dhe 15 vjeçar të mitur, të dy nga Shkupi, nga njëra anë, dhe 15-vjeçari i mitur nga fsh. Shishovë, nga ana tjetër, e kanë prishur rendin dhe qetësinë publike nga një përleshje fizike. Janë përpiluar procesverbale për kundërvajtjet e konstatuara sipas Nenit 12 të Ligjit për kundërvajtje, kundër rendit dhe qetësisë publike.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 2.10.2020, ora 20:50 në afërsi të Parkut të qytetit të Shkupit, menjëherë para hyrjes në stadium.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: 3 viktima, të gjithë të mitur, një 14-vjeçar dhe dy djem 15-vjeçarë.

Lloji i veprës penale: Dhunë (Neni 386 i Kodit penal).

Autori: 3 autorë, të gjithë të mitur, një 14-vjeçar dhe dy djem 15-vjeçarë.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident motivi i njëanshëm është origjina e supozuar etnike dhe përleshja u zhvillua sepse djemtë flisnin gjuhë të ndryshme, lurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Gjuha e folur* – viktima dhe sulmuesi flisnin gjuhë të ndryshme;
2. *Prejardhja etnike* – viktima dhe sulmuesi u përkisnin bashkësive të ndryshme etnike.

Statusi i rastit: SP Qendër ka përpiluar një procesverbal kundërvajtje të konstatuar sipas Nenit 12 të Ligjit për kundërvajtje, kundër të gjithë personave të përfshirë në incident.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Autoritetet mendojnë se me padi kundërvajtjeje, sulmi fizik është zbardhur.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike dhe gjuhësore në shoqëri.

84. Një vatg incidentesh në fsh. Kravari gjatë zhvillimit të një ndeshje futbollit

Çfarë ka ndodhur: Më 11.10.2020 në ora 18.00 në stacionin policor Vellushnicë-Manastir, A.S. (41) nga fsh. Drslajca i Strumicës, arbitër futbollit, ka paraqitur se rreth orës 15.45 në fsh. Kravari, në një ndeshje

futbollit, ka qenë i sulmuar fizikisht nga A.R. (25) nga Manastiri, J.Q. (23) dhe A.M.(32), të dy nga fsh. Grnçari i Resnjes. Teksa J.Q. ka paraqitur se derisa ishte në pauzë të ndeshjes së futbollit në fsh. Kravari, ka qenë i sulmuar fizikisht nga G.Ll. (43) nga Struga, ndihmës arbitër. Janë ndërmarrë masa për zbardhjen e rastit.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 11.10.2020, ora 18:00 në fsh. Kravari, Manastir.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Dy viktima, 23-vjeçar dhe 41-vjeçar.

Lloji i veprës penale: Dhunë (Neni 386 i Kodit penal).

Autori: 4 autorë, të moshës prej 23, 25, 32 dhe 43 vjeç.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Motivi i njëanshëm në këtë incident është origjina etnike sepse arbitri i futbollit dhe ndihmësi i tij u sulmuan për shkak të përkatësisë etnike të tyre dhe u fyen mbi atë bazë, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Prejardhja etnike* – viktima dhe sulmuesi u përkisnin bashkësive të ndryshme etnike;
2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – përlëshje gjatë ndeshjeve sportive.

Statusi i rastit: Nga ana e SPB Manastir – Vellushinë janë ndërmarrë masa dhe aktivitete për zbardhjen e rastit.

Përgjigja e autoriteteve lokale: autoritetet besojnë se akuzat për kundërvajtje do të ngrihen kundër autorëve në përputhje me Ligjin për parandalimin e dhunës dhe sjelljes së pahijshme në gara sportive.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji e sjellin në pyetje gjendjen e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

85. Brutalitet policor me elemente të hakmarrjes kundër romëve në Manastir

Çfarë ka ndodhur: Më 21 tetor 2020, vetëm disa javë pas rastit të romëve të rrahur nga nëpunësit policorë në Manastir, iniciativa civile AVAJA ndau informacion me publikun në lidhje me një rast të ri në Manastir me indikacione të brutalitetit policor, por edhe me elemente hakmarrjeje nga nëpunësit policorë. Sipas AVAJA, kësaj radhe policia përdori forcë të tepruar ndaj një gruaje të moshuar rome dhe djalit të saj: "Djali i gruas kishte dalë në pushim nga puna për të ngrënë dhe nuk ka mbajtur maskë në atë çast sepse ka qenë duke ngrënë, por polici ka kërkuar ta legjitimojë sepse nuk ka mbajtur maskë, me qëllimin për ta gjobitur (MEGJITHËSE MASAT ENDE NUK ISHIN MIRATUAR). Kartën e identitetit nuk e kishte me vete, kështu që nëna e tij i tha policit që të merrte letërnjoftimin e saj. Polici kishte kërkuar përforcime dhe djali u privua nga liria së bashku me nënën sepse ajo nuk donte ta linte djalin vetëm. Pasi hipën në furgonin e policisë, djali dhe gruaja ishin rrahur dhunshëm! Ndërsa po rriheshin, polici u kishte thënë: "Gjuptini, hajde, regjistroni tani, nuk mund të më bësh asgjë!" Gruaja e rrahur është në gjendje të rëndë shëndetësore! Pasi u rrah, duhej të ndërhynte edhe ambulanca! Gruaja me astmë e pa veten të paaftë të merrte frymë për shkak të sulmit!!! Gruaja aktualisht është nën stres të lartë dhe me shëndet të rrezikuar! Burri i saj u përpoq të raportonte rastin në stacionin e policisë tre herë gjatë ditës, por nuk kishte kush ta pranonte. Për momentin, burri i gruas do të përpiqet përsëri të raportojë rastin në policinë e Manastirit - ne presim që policia ta pranojë qytetarin këtë herë dhe të marrë masat e duhura!!! "Në të njëjtën kohë, është një situatë shqetësuese që kemi një përpjekje tjetër për të mbuluar ngjarjen, me anë të mosveprimit në kohë dhe mosveprimit në përgjithësi nga nëpunësit e tjerë policorë, fakt që kërkon nevojën e reformave serioze në funksionimin e policisë!", informoi AVAJA. Komiteti i Helsinkit dhe Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj, përmes një projekti të përbashkët, për këtë rast angazhuan një avokat. Gruaja dhe djali i saj nuk janë ndaluar në paraburgim dhe aktualisht po ndihen mirë, por policia për kohë të gjatë ka refuzuar të marrë denoncimin.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 20.10.2020, rreth orës 14.00, në Manastir.

Burimi i informacionit: Rrjetet sociale, mediumet elektronike, gazetat dhe televizionet.

Viktima të përfshira: 2 (dy) viktima, mashkull dhe grua, të rritur (djalë dhe nënë).

Lloji i veprës penale: Maltretim gjatë kryerjes së detyrës (Neni 143 i Kodit penal).

Autori: dy (2) autorë, nëpunës policorë.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Motivi i njëanshëm në këtë incident është ngjyra e lëkurës, origjina e supozuar etnike dhe gjuha, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Gjuha e folur* – viktima dhe sulmuesi flisnin gjuhë të ndryshme;
2. *Ngjyra e lëkurës* – viktima kishte ngjyrë të ndryshme të lëkurës nga sulmuesi për shkak së cilës edhe u sulmuan;
3. *Prejardhja etnike* – viktima dhe sulmuesi u përkisnin bashkësive të ndryshme etnike;
4. *Vendndodhja* – Manastiri është një komunë e disa bashkësive etnike dhe ky lloj i incidenteve është regjistruar edhe më parë, veçanërisht ku viktimat janë anëtarë të komunitetit rom.

Statusi i rastit: Pas hetimit, është duke u zhvilluar një procedurë para Gjykatës Themelore Penale në Manastir.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Nuk ka konfirmim për indikatorët nga MPB për këtë incident.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike dhe gjuhësore në shoqëri dhe ulin ndjeshëm besimin e qytetarëve në polici. Duke pasur parasysh indikacionet shqetësuese, Departamenti i kontrollit të brendshëm, hetimeve kriminalistike dhe standardeve profesionale në Ministrinë e Punëve të Brendshme duhet të kishte hetuar plotësisht këtë rast dhe nëse konfirmoheshin gjetjet, nëpunësit e përfshirë policorë duhet të ishin gjobitur si duhet dhe, nëse ka arsye, kundër tyre të fillohej një procedim penal. Fatkeqësisht, ky nuk ishte rasti as në këtë incident dhe procedimet u kryen tërësisht nga viktimat, dëshmitarët e drejtpërdrejtë dhe organizatat e shoqërisë civile.

86. Sulm fizik ndaj një të mituri në Aerodrom, Shkup

Çfarë ka ndodhur: Më 24.10.2020 në ora 02.03 në SPB Shkup është paraqitur se më 23.10.2020 rreth orës 22.50 në rajonin e Aerodromit, 16-vjeçari nga Shkupi ka qenë i sulmuar fizikisht nga disa persona. Po punohet për zbardhjen e rastit.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 23.10.2020, rreth orës 22:50 në rajonin e komunës së Aerodromit, Shkup.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Një viktimitë, i mitur, 16-vjeçar nga Shkupi.

Lloji i veprës penale: Dhunë (Neni 386 i Kodit penal).

Autori: Dy autorë, burra të rritur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Motivi i njëanshëm në këtë incident është origjina e supozuar etnike sepse djali u sulmua për arsye se ka folur një gjuhë tjetër, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Gjuha e folur* – viktima dhe sulmuesi flisnin gjuhë të ndryshme;
2. *Prejardhja etnike* – viktima dhe sulmuesi u përkisnin bashkësive të ndryshme etnike.

Statusi i rastit: SP Aerodrom ka përpiluar procesverbale për kundërvajtje të konstatuar sipas nenit 12 të Ligjit për kundërvajtje, kundër dy autorëve.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Autoritetet mendojnë se me padi kundërvajtjeje, sulmi fizik është zgjidhur.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike dhe gjuhësore në shoqëri.

87. Sulm fizik në afërsi të Parkut të qytetit të Shkupit

Çfarë ka ndodhur: Më 25.10.2020 në ora 00.50 A.J. (20) nga Shkupi ka paraqitur se në Parkun e qytetit ai dhe M.J. (19) ishin sulmuar fizikisht nga disa persona. Po punohet për zbardhjen e rastit.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 25.10.2020, rreth orës 00:50, në afërsi të Parkut të qytetit të Shkupit.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Dy viktima, burra të rritur, 19 dhe 20-vjeçar nga Shkupi.

Lloji i veprës penale: Dhunë (Neni 386 i Kodit penal).

Autori: Më shumë autorë, të gjithë burra.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Motivi i njëanshëm në këtë incident është origjina e supozuar etnike sepse viktimat u sulmuan sepse kanë folur në një gjuhë tjetër, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Gjuha e folur* – viktima dhe sulmuesi flisnin gjuhë të ndryshme;
2. *Prejardhja etnike* – viktima dhe sulmuesi u përkisnin bashkësive të ndryshme etnike.

Statusi i rastit: SP Karposh ka përpiluar një provesverbal mbi pranimin e një denoncimi sipas nenit 12 të Ligjit, kundër disa autorëve.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Janë ndërmarrë masa për zbardhjen e rastit.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike dhe gjuhësore në shoqëri.

88. Migrant i sulmuar në afërsi të fshatit Umin Doll, i Kumanovës

Çfarë ka ndodhur: Më 29.10.2020 në SPB Kumanovë është paraqitur se rreth orës 13.00 në fsh. Umin Doll të Kumanovës, një person me kërcënim i mori para M.U –së (26) nga Pakistani. Janë ndërmarrë masa për zbardhjen e rastit.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 29.10.2020, rreth orës 13.00 në afërsi të fshatit Umin Doll, Kumanovë.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Një (1) viktimë, mashkull 26-vjeçar.

Lloji i veprës penale: Grabitje (Neni 237 i Kodit Penal).

Autori: Një person, mashkull i rritur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Motivi i njëanshëm në këtë incident është statusi i refugjatit ose migrantit, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Statusi i refugjatit ose migrantit* – viktima është mashkull me status migrant;

2. *Vendndodhja* – Incidenti ndodhi në një vend ku kalon rruga e migrantëve dhe refugjatëve që tranzitojnë nëpër vend.

Statusi i rastit: SP Kumanovë ngriti padi penale kundër D.S. nga Shkupi në Prokurorinë Publike në Kumanovë për shkak të dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale "Grabitje" nga neni 237 i Kodit Penal.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Procedura është në zhvillim e sipër.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme në shoqëri, dhe veçanërisht sigurinë e refugjatëve dhe migrantëve që kalojnë nëpër territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

89. Kërcënim për jetën e një mashkulli "gej" për shkak të orientimit të tij seksual

Çfarë ka ndodhur: Më 30.10.2020, pasi në Facebook pranoi kërcënime serioze për jetën e tij për shkak se i përket komunitetit LGBTI dhe për shkak se në komente mbronte të drejtat dhe liritë e anëtarëve të këtij komuniteti, më 30 tetor, personi D.P. u drejtua në Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut me kërkesë për ndihmë juridike falas. Prej përmbajtjes së kërcënimeve që i pranoi, mund të konstatohet se kërcënuesi në të kaluarën, jo vetëm verbalisht, por edhe fizikisht ka sulmuar dhe maltretuar pjesëtarë të komuniteteve të marginalizuara.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 30.10.2020, rreth orës 11 në rrjetin social Facebook.

Burimi i informacionit: Zyra për ndihmë juridike falas e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.

Viktima të përfshira: Një viktimë, 35-vjeçar.

Lloji i veprës penale: Rrezikim i sigurisë (Neni 144 paragrafi 2 i Kodit Penal).

Autori: Një autor, i moshës rreth 40 vjeç.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident motivi i njëanshëm është orientimi seksual, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Orientimi seksual* – prania e komunitetit LGBTI në hapësirën publike dhe në internet është një shënjestër e dhunës dhe grupi shpesh është i ekspozuar nga kërcënimet;

2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – prani e gjuhës së urrejtjes dhe sulme të mëparshme ndaj personave të komunitetit LGBTI.

Statusi i rastit: Ekipi i Komitetit të Helsinkit, së bashku me viktimën, ngritën kallëzime penale në stacionin policor Qendër - SP Beko bazuar në nenin 144 të Kodit Penal për veprën penale "Rrezikimi i sigurisë", me theks të veçantë në paragrafin 2 si formë e kualifikuar e një vepre të kryer nga urrejtja.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Në vend që provat e siguruara të ishin bazë për nëpunësit policorë për të vepruar me një akuzë penale (duke kontaktuar një prokuror kompetent dhe një inspektor të krimit kibernetik), nëpunësit policorë të pranishëm morën rolin e prokurorit, duke interpretuar ligjin vetë, duke argumentuar se akuza duhet të regjistrohet si një ankesë e thjeshtë dhe viktimë të kërkojë më tej mbrojtje ligjore në një proces gjyqësor privat. Ky vullnetarizëm i punonjësve të policisë nuk është i ri. Përkundrazi, kur raportohet një seri e krimeve të urrejtjes, sjellja e policëve është e njëjtë, e pacipë dhe joprofionale. Sidoqoftë, fakti që viktimë ishte këmbëngulës dhe shoqërohej nga një këshilltar ligjor, rezultoi me procedimin penal të krimit sipas detyrës zyrtare.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend, kohezionin midis grupeve të ndryshme në shoqëri, dhe veçanërisht sigurinë dhe shëndetin e personave LGBTI.

90. Sulm fizik ndaj dy të miturve në Gjorçe Petrov

Çfarë ka ndodhur: Më 01.11.2020 në ora 20.46 në SPB Shkup është paraqitur se në Gjorçe Petrov dy të mitur nga Shkupi ishin sulmuar fizikisht nga disa persona, prej të cilëve njëri kishte me vete objekt të mprehtë. Janë ndërmarrë masa për zbardhjen e rastit.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 1.11.2020, në ora 20:46 në komunën Gjorçe Petrov, Shkup.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Dy viktima të mitur.

Lloji i veprës penale: Dhunë (Neni 386 i Kodit penal).

Autori: Grup autorësh, prej të cilëve së paku njëri kishte objekt të mprehtë.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina e supozuar etnike për shkak se sulmi ndodhi sepse djemtë flisnin gjuhë të ndryshme, kurse indikatorë e njëanshëm janë:

1. *Gjuha e folur* – të miturit në fjalë flisnin gjuhë të ndryshme;
2. *Prejardhja etnike* – personat e përfshirë u perkisnin bashkësive të ndryshme etnike.

Statusi i rastit: SPB Shkup paraqiti një njoftim në Prokurorinë Publike Shkup kundër një autori të panjohur për veprën penale "Dhunë" nga neni 386 i Kodit Penal.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Janë ndërmarrë masa për zbardhjen e rastit.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike dhe gjuhësore në shoqëri.

91. Plagë me thikë shkaktuar një shtetasi turk gjatë një sulmi fizik

Çfarë ka ndodhur: Më 10.11.2020 në ora 21.23, në SPB Shkup është paraqitur se në kompleksin klinik "Nënë Tereza" është lënduar A.O.U. (29) nga R. e Turqisë, i cili ka qëndruar në Shkup, ku iu konstatuan lëndime të rënda fizike, të cilat i ka marrë nga një sulm fizik në Qendër nga disa persona, kurse gjatë sulmit njëri prej personave i shkaktoi plagë nga therrja me thikë. Janë ndërmarrë masa për zbardhjen e rastit.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 10.11.2020, ora 21:23 në komunën Qendër, Shkup.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Një viktimë, mashkull, 29 vjeç.

Lloji i veprës penale: Lëndim i rëndë trupor (Neni 131 i Kodit Penal).

Autori: Grup autorësh, prej të cilëve së paku njëri kishte objekt të mprehtë.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Motivi i njëanshëm në këtë incident është origjina e supozuar kombëtare sepse sulmi ndodhi për shkak se viktima është anëtar i një kombësie tjetër, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Gjuha e folur* – viktima fliste gjuhë të ndryshme nga sulmuesit;
2. *Prejardhja etnike* – personat e përfshirë u perkisnin bashkësive të ndryshme etnike.

Statusi i rastit: SPB Shkup parashtroi një njoftim në Prokurorinë Publike Shkup kundër një autori të panjohur për veprën penale "Lëndim i rëndë trupor" nga neni 131 i Kodit Penal.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Autoritetet u përgjigjën se janë ndërmarrë masa për zgjidhjen e rastit.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike dhe gjuhësore në shoqëri.

92. Sulm fizik në afërsi të sheshit të lojërave në lagjen Gazi Babë

Çfarë ka ndodhur: Më 13.11.2020 në ora 15.00 në SPB Shkup, A.S. (19) prej fsh. Idrizovë të Shkupit, ka paraqitur se rreth orës 13.30 në afërsi të sheshit të lojërave në Gazi Babë ka qenë i sulmuar fizikisht nga një person i mitur. Janë ndërmarrë masa për zbardhjen e rastit.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 13.11.2020, rreth orës 13:30 në afërsi të sheshit të lojërave në Gazi Babë, Shkup.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Një viktimë, mashkull, 19-vjeçar nga fsh. Idrizovë, Shkup.

Lloji i veprës penale: Dhunë (Neni 386 i Kodit Penal).

Autori: Një autor, i mitur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina e supozuar etnike sepse viktima u sulmua sepse ka folur në një gjuhë tjetër, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Gjuha e folur* – viktima dhe sulmuesi flisnin gjuhë të ndryshme;
2. *Prejardhja etnike* – viktima dhe sulmuesi u përkisnin bashkësive të ndryshme etnike.

Statusi i rastit: SP Aerodrom ka përpiluar një procesverbal për kundërvajtje të konstatuar sipas nenit 12 të Ligjit për kundërvajtje, kundër një personi.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Autoritetet u përgjigjën se janë ndërmarrë masa për zbardhjen e rastit.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike dhe gjuhësore në shoqëri.

93. Sulm fizik ndaj një shtetasi të Republikës së Shqipërisë

Çfarë ka ndodhur: Më 13.11.2020 rreth orës 22.30 në SPB Strumicë, A.K. prej R. së Shqipërisë ka paraqitur se në kazononë në Vallandovë ka qenë i sulmuar fizikisht nga S.U. (55) nga Vallandova. Janë ndërmarrë masa për zbardhjen e rastit.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 13.11. 2020, ora 22:30 në territorin e komunës së Vallandovës.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Një viktimë, mashkull i rritur, shtetas i huaj.

Lloji i veprës penale: Dhunë (Neni 386 i Kodit Penal).

Autori: Një autor, mashkull 55-vjeçar nga Vallandova.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Motivi i njëanshëm në këtë incident është origjina e supozuar kombëtare sepse sulmi ndodhi sepse viktima është anëtar i një kombësie tjetër, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Gjuha e folur* – viktima fliste gjuhë të ndryshme nga sulmuesit;
2. *Prejardhja etnike* – personat e përfshirë u përkisnin bashkësive të ndryshme etnike.

Statusi i rastit: SP Vallandovë parashtroi një kërkesë në gjykatën kompetente për të filluar një procedurë të kundërvajtjes kundër U.S. (55) nga Vallandova, për një kundërvajtje sipas neneve 6 dhe 12 të Ligjit në fjalë.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Autoritetet mendojnë se me padi kundërvajtjeje, sulmi fizik është zgjidhur.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme kombëtare, etnike dhe gjuhësore në shoqëri.

94. Sulm fizik ndaj një djaloshi 18-vjeçar në Bit Pazar

Çfarë ka ndodhur: Më 19 nëntor 2020, në stacionin policor “Bit Pazar” nga ana e një djaloshi 18-vjeçar është paraqitur se ishte sulmuar nga ana e një burri të panjohur në pjesën e Bit Pazarit. Supozohet se arsyeja e sulmit është përkatësia e tij e ndryshme etnike.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 19.11.2020, ora 15:40, Bit Pazar, komuna e Çairit, Shkup.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Një viktimë, mashkull 18-vjeçar.

Lloji i veprës penale: Dhunë (Neni 386 i Kodit Penal).

Autori: Një autor i panjohur, mashkull.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Motivi i njëanshëm në këtë incident është origjina e supozuar etnike sepse sulmi ka ndodhur sepse djali është i një etnie të ndryshme nga sulmuesi, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Gjuha e folur* – viktimja fliste gjuhë të ndryshme nga sulmuesit;
2. *Prejardhja etnike* – personat e përfshirë u perkisnin bashkësive të ndryshme etnike;
3. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – sulme të mëparshme në këtë vend.

Statusi i rastit: Hetimi është në zhvillim e sipër dhe po punohet për kapjen e autorëve.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Nga stacioni policor thonë se pas zbardhjes së plotë dhe dokumentimit të rastit, do të ngriten shkresa përkatëse.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike dhe gjuhësore në shoqëri.

95. Përleshje midis tetë të miturve të moshës nga 14 deri 17 vjeç

Çfarë ka ndodhur: Më 21 nëntor 2020, në stacionin policor “Gjorçe Petrov” nga ana e nëpunësve policorë ishin ndaluar tetë persona të mitur të moshës nga 14 deri 17 vjeç. Policia ka vepruar sipas një denoncimi, sipas të cilit në ora 21.30 po të njëjtën ditë, në lagjen e komunës Gjorçe Petrov, në afërsi të objektit hotelierik, disa persona me objekte të mprehta kanë sulmuar dy të mitur, të cilët ishin së bashku me tre shokë. Arsyeja për sulmin dhe përleshjen e mëvonshme është përkatësia e ndryshme etnike e të miturve. Nga stacioni policor thonë se pas zbardhjes së plotë dhe dokumentimit të rastit, do të ngriten shkresat përkatëse.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 21.11.2020, ora 21:30 në komunën Gjorçe Petrov, Shkup.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Pesë viktimja, prej të cilëve dy të mitur, të gjithë meshkuj.

Lloji i veprës penale: Dhunë (Neni 386 i Kodit Penal).

Autori: Tetë autorë, të gjithë të mitur të moshës nga 14 deri 17 vjeç.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Motivi i njëanshëm në këtë incident është origjina e supozuar etnike sepse sulmi ndodhi sepse djemtë flisnin gjuhë të ndryshme, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Gjuha e folur* – të miturit në fjalë flisnin gjuhë të ndryshme;
2. *Prejardhja etnike* – personat e përfshirë u perkisnin bashkësive të ndryshme etnike.

Statusi i rastit: Rasti u zbardh nga SPN Shkup, autorët u zbuluan dhe një akuzë penale u parashtrua në Prokurorinë Publike Shkup.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Autoritetet mendojnë se me masat e ndërmarra, rasti është zgjidhur.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike dhe gjuhësore në shoqëri.

96. Përdhosja e monumentit të turistëve bullgarë në Ohër

Çfarë ka ndodhur: Më 27.11.2020 në orët e paraditës në Ohër është dëmtuar monumenti në bregun e Liqenit të Ohrit, i cili ishte ngritur si përmendore për turistët bullgarë që humbën jetën gjatë një aksidentit duke udhëtuar me anijen ‘Ilinden’, ku pësuan turistët bullgarë, ngjarje e ndodhur më 5 shtator 2009.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 27.11.2020, në orët e paraditës, në territorin e komunës së Ohrit.

Burimi i informacionit: Rrjete sociale, medime elektronike, gazeta dhe televizione.

Viktima të përfshira: Të papërcaktuar.

Lloji i veprës penale: Nxitje e urrejtjes, përçarjes dhe intolerancës kombëtare, racore dhe fetare dhe diskriminim tjetër (Neni 319 i Kodit Penal).

Autori: Grup autorësh.

Përshkrimi i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Motivi i njëanshëm në këtë incident është baza kombëtare, sepse sulmi ndodhi sepse monumenti u kushtohet turistëve bullgarë, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – përdhosje të mëparshme të përmendoreve të natyrës së ngjashme;
2. *Koha e incidentit* – menjëherë pas vetos bullgare të kornizës negociuese për Republikën e Maqedonisë së Veriut për anëtarësim në Bashkimin Evropian;
3. *Baza kombëtare* – përmendorja është kushtuar turistëve bullgarë.

Statusi i rastit: Janë ndërmarrë masa për zbardhjen e rastit.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Ministria e Punëve të Jashtme e dënoi aktin vandal, kurse hetimi është në zhvillim e sipër.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidente të këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe jetën midis grupeve të ndryshme kombëtare, etnike dhe gjuhësore në shoqëri.

97. Grabitje e kishës në Tetovë

Çfarë ka ndodhur: Më 05.12.2020 në pjesë të caktuar të ditës, një autor i panjohur ka hyrë në kishën “Presveta Bogorodica” në Tetovë dhe ka marrë paratë e grumbulluara nga besimtarët.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 05.12.2020 në një pjesë të caktuar të ditës, në kishën “Presveta Bogorodica” në Tetovë.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Të papërcaktuara.

Lloji i veprës penale: Grabitje e dhunshme (Neni 238 i Kodit Penal), Dëm ndaj një objekti të huaj (Neni 243 i Kodit Penal).

Autori: Autor i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Motivi i njëanshëm në këtë incident është besimi fetar, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Lokacion i synuar* – objekt fetar;
2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – incidente të mëparshme të natyrës së ngjashme.

Statusi i rastit: Autori është ende në kërkim.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Nën punësit policorë nga SP Tetovë inspektuan vendin dhe po marrin masa për zbardhjen e plotë të rastit.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji e sjellin në pyetje gjendjen e përgjithshme të sigurisë në vend.

98. Djegie e flamurit shtetëror në stacionin hekurudhor "Shkup Veri"

Çfarë ka ndodhur: Më 08.12.2020 në ora 07.12 në SPB Shkup, G.J.Z., i punësuar në Hekurudhat e Maqedonisë së Veriut ka paraqitur se në stacionin hekurudhor "Shkup Veri", një person e ka djegur flamurin shtetëror i cili gjendej në shtyllë. Janë ndërmarrë masa për zbardhjen e rastit.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 8.12. 2020, në orët e hershme të mëngjesit, në territorin e qytetit të Shkupit.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Të papërcaktuar.

Lloji i veprës penale: Nxitje e urrejtjes, përçarjes dhe intolerancës kombëtare, racore dhe fetare dhe diskriminim tjetër (Neni 319 i Kodit Penal).

Autori: I panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është baza kombëtare sepse sulmi ndodhi sepse flamuri është simbol i shtetit të Maqedonisë së Veriut, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – incidente të mëparshme të natyrës së ngjashme;
2. *Baza kombëtare* – djegja e flamurit të ndonjë shteti të caktuar.

Statusi i rastit: Janë ndërmarrë masa për zbardhjen e rastit.

Përgjigja e autoriteteve lokale: E panjohur.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji e sjellin në pyetje gjendjen e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme kombëtare, etnike dhe gjuhësore në shoqëri.

99. Sulm fizik ndaj një burri 22-vjeçar dhe dëmtimi i veturës së tij

Çfarë ka ndodhur: Më 11.12.2020, një 22-vjeçar, banor i Shkupi ka paraqitur në polici se dy persona të panjohur, e kishin sulmuar fizikisht dhe gjatë kësaj ia kanë dëmtuar automjetin.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 11.12.2020, ora 10:00 në rrugën "Makedonsko-Kosovska Brigada" në komunën e Çairit, Shkup.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Një viktimë, mashkull 22-vjeçar.

Lloji i veprës penale: Dhunë (Neni 386 i Kodit Penal) dhe Dëmtim i objektit të huaj (Neni 243 i Kodit Penal).

Autori: Dy autorë.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina e supozuar etnike sepse sulmi ndodhi sepse viktima fliste një gjuhë tjetër nga sulmuesit, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Gjuha e folur* – viktima fliste gjuhë të ndryshme nga sulmuesit;
2. *Prejardhja etnike* – personat e përfshirë u perkisnin bashkësive të ndryshme etnike.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Janë ndërmarrë masa për zbardhjen e rastit.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike dhe gjuhësore në shoqëri.

100. Ngacmim dhe kërcënim për shkak të aftësisë së kufizuar intelektuale

Çfarë ka ndodhur: Më 12.12.2020, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut regjistroi një rast të raportuar nga një prind i një fëmije me autizëm. Gjegjësisht, e gjithë familja vuan nga ngacmimet dhe kërcënimet e dy fqinjëve në ndërtesën e banesës në të cilën jetojnë. Fqinjët vazhdimisht shkelmonin dhe godisnin me grusht derën e banesës së familjes, duke bërë titur se do t'i vrisnin ata dhe fëmijën e tyre 9-vjeçar me autizëm, sepse u pengonte zhurma që bëhej nga fëmija që ata e kishin quajtur në mënyrë të përsëritur "mendërisht".

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: Vazhdimisht gjatë dy viteve të mëparshme në territorin e komunës së Manastirit .

Burimi i informacionit: Denoncim në Komitetin e Helsinkit.

Viktima të përfshira: Dy viktima, fëmijë i mitur dhe prindi.

Lloji i veprës penale: Rrezikim i sigurisë (Neni 144 i Kodit Penal).

Autori: Dy autorë, meshkuj të rritur, fqinj të viktimës.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Motivi i njëanshëm në këtë incident është aftësia e kufizuar e fëmijës sepse ngacmimi dhe kërcënimet ndodhin mbi këtë bazë, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – incidente të mëparshme të natyrës së ngjashme;
2. *Pengesë/Aftësi e kufizuar* – Fqinjët vazhdimisht shkelmonin dhe godisnin me grusht derën e banesës së familjes, duke bërë titur se do t'i vrisnin ata dhe fëmijën e tyre 9-vjeçar me autizëm, sepse mendonin se zhurma e pretenduar ishte shkaktuar nga fëmija që ata e kishin quajtur vazhdimisht "mendërisht".

Statusi i rastit: Familja raportoi rastin në stacionin policor, por gjithçka përfundoi me një raport policor, pas të cilit nuk pati asnjë reagim nga institucionet për ngacmimet e familjes dhe fëmijës me aftësi të kufizuara intelektuale nga fqinjët. Gjegjësisht, në vitin 2018, policia ngriti kallëzim penal për veprën "Rrezikimi i Sigurisë" sipas Nenit 144 të Kodit Penal, i cili u refuzua nga zyra e prokurorit publik kompetent sepse ngjarja specifike nuk plotësonte elementet e një krimi të ndjekur zyrtarisht. Në përputhje me këshillat juridike të Prokurorisë Publike, familja ngriti një padi penale private kundër autorëve. Një seancë dëgjimore mbi padinë penale është caktuar për në mars të këtij viti dhe ekipi juridik i Komitetit të Helsinkit do të monitorojë procedurat gjyqësore. Në këtë kuptim, duhet të theksohet se krimet e urretjes nuk ndodhin në

një vakum, ato janë një manifestim i dhunshëm i paragjykimit që depërton thellë në shoqëri. Duke marrë parasysh këtë, vepra penale "rrezikimi i sigurisë" të një të mituri për shkak të aftësive të tij të kufizuara intelektuale, i cili padyshim motivohet nga intoleranca dhe paragjykimi ndaj anëtarëve të këtij grupi të prekshëm, mund të cilësohet si vepër penale nga urrejtja. Prokuroria Themelore Publike hodhi poshtë gabimisht akuzat penale duke e cilësuar gabimisht veprën penale. Për shkak të kësaj, Komiteti i Helsinkit do të parashtrojë padi penale kundër autorëve për veprën penale "Rrezikimi i sigurisë", si një vepër penale nga urrejtja.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Përkundër faktit se ngacmimi ka qenë i vazhdueshëm dhe është raportuar në polici disa herë, familja mori vetëm një njoftim nga stacioni i policisë se fqinjët ishin paralajmëruar vetëm verbalisht, pa shpjegime shtesë. Për shkak të trajtimit diskriminues nga fqinjët dhe trajtimit joadekuat për të mbrojtur familjen nga diskriminimi policor, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut do të sigurojë ndihmë juridike familjes për të bërë një ankesë në Komisionin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, menjëherë pas zgjedhjes së tij anëtarëve, për shkak të diskriminimit të kryer në lidhje me aftësinë e kufizuar të fëmijës. Për më tepër, Komiteti i Helsinkit do të paraqesë një ankesë në Departamentin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në mënyrë që të hetojë sjelljen joprofesionale dhe të paligjshme të nëpunësve policorë.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji rrezikojnë sigurinë e përgjithshme të familjes dhe veçanërisht rrezikojnë lëvizjen e lirë të të miturit. Ky qëndrim ndaj personave me aftësi të kufizuara intelektuale reflektohet më tej në diskursin publik dhe kontribuon në stigmatizimin e tyre në shoqëri.

101. Sulm fizik ndaj një 19-vjeçari në Shkup

Çfarë ka ndodhur: Më 12.12.2020 në ora 21.01 në SP Aerodrom, një person 19-vjeçar ka paraqitur se ishte sulmuar fizikisht nga më shumë persona në afërsi të Qendrës së Transportit Publik - Shkup .

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 12.12.2020, në ora 23:01 në komunën Aerodrom, Shkup.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Një viktimë, mashkull 19-vjeçar.

Lloji i veprës penale: Dhunë (Neni 386 i Kodit Penal).

Autori: Grup autorësh të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina e supozuar etnike sepse sulmi ndodhi sepse viktima fliste një gjuhë tjetër nga sulmuesit, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Gjuha e folur* – viktima fliste gjuhë të ndryshme nga sulmuesit;
2. *Prejardhja etnike* – personat e përfshirë u perkisnin bashkësive të ndryshme etnike.

Statusi i rastit: Nga ana e SPB Shkup ende po punohet për zbulimin e autorëve.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Janë ndërmarrë masa për zbardhjen e rastit.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike dhe gjuhësore në shoqëri.

102. Sulm fizik nga ana e tre personave

Çfarë ka ndodhur: Më 16.12.2020 në ora 16.49 në SPB Shkup, D.M. ka paraqitur se në rr. "Vera Radosavleviq" ai dhe R.Q. ishin sulmuar fizikisht nga tre personav.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 16.12.2020, ora 16:49 në komunën e Gazi Babës, Shkup.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Dy viktima, meshkuj të rritur.

Lloji i veprës penale: Dhunë (Neni 386 i Kodit Penal).

Autori: Tre autorë, të gjithë të rritur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Motivi i njëanshëm në këtë incident është origjina e supozuar etnike sepse sulmi ndodhi sepse viktimat flisnin një gjuhë tjetër nga sulmuesit, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Gjuha e folur* – viktimat në fjalë flisnin gjuhë të ndryshme prej sulmuesve;
2. *Prejardhja etnike* – personat e përfshirë u perkisnin bashkësive të ndryshme etnike.

Statusi i rastit: Nga ana e SPB Shkup ende po punohet në zbulimin e autorëve.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Janë ndërmarrë masa për zbardhjen e rastit.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike dhe gjuhësore në shoqëri.

103. Sulm fizik ndaj një të mituri në Gazi Babë

Çfarë ka ndodhur: Më 16.12.2020 në ora 20.00 në Gazi Babë, një prind 43-vjeçar ka paraqitur se djali i tij ka qenë i sulmuar fizikisht nga një grup i panjohur njerëzish, pa ndonjë arsyë konkrete.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 16.12.2020, ora 20:00 në komunën Gazi Babë, Shkup.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Një viktimë, i mitur, mashkull.

Lloji i veprës penale: Dhunë (Neni 386 i Kodit Penal).

Autori: Më shumë autorë të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është origjina e supozuar etnike sepse sulmi ndodhi sepse viktima fliste një gjuhë tjetër nga sulmuesit, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Gjuha e folur* – viktimat në fjalë flisnin gjuhë të ndryshme nga sulmuesit;
2. *Prejardhja etnike* – personat e përfshirë u perkitsnin bashkësive të ndryshme etnike.

Statusi i rastit: Nga ana e SPB Shkup ende po punohet për zbulimin e autorëve.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Janë ndërmarrë masa për zbardhjen e rastit.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike dhe gjuhësore në shoqëri.

104. Fotografi dhe shkrim me ofendime që nxisin dhunë

Çfarë ka ndodhur: Më 23.12.2020, Departamenti për punë të brendshme Prilep ka ngritur padi penale kundër S.M. (36) nga Prilepi për shkak të dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale “Shpërndarje e materialit racist dhe ksenofobik përmes sistemeve kompjuterike”. S.M. më 28.10.2020 nëpërmjet profilit të tij në Facebook, në një koment të një profili tjetër në Facebook ka publikuar fotografi dhe shkrim me ofendime që nxisin dhunë.

Data, koha dhe vendndodhja e incidentit: 28.10. 2020, në rrjetin social Facebook.

Burimi i informacionit: Buletini ditor i MPB-së.

Viktima të përfshira: Të papërcaktuara.

Lloji i veprës penale: Shpërndarje e materialit racist dhe ksenofobik përmes sistemeve kompjuterike (Neni 394-g paragrafi 2 i Kodit Penal).

Autori: Mashkull 36-vjeçar nga Prilepi.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia etnike sepse fotografia dhe mbishkrimi me fyerje që nxisin dhunë kanë për qëllim një grup specifik etnik në vend, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Gjuha e folur* – autori i përket një bashkësie etnike, ndërsa nxit dhunë ndaj një bashkësie tjetër të ndryshme etnike;
2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – incidente të mëparshme të natyrës së ngjashme.

Statusi i rastit: Ka filluar procedura penale gjyqësore.

Përgjigja e autoriteteve lokale: Padi penale kundër autorit.

Ndikimi ndaj viktimave dhe komunitetit: Incidentet e këtij lloji vënë në pikëpyetje situatën e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike dhe gjuhësore në shoqëri.